

Bogov
Të tatimohen
segmentet që
s'janë tatimuar

Fq.3



**BUJAR
OSMANI**

Është realizuar
mbi 90 për qind
e Plani 3-6-9

Fq.4



BAJERN - REAL
finale e parakohshme

Fq.22



Koha

www.koha.mk



**Ballkani, testi
i ri i Luftës
së Ftohtë**

Fq.12

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3341 · e shtunë/e diel 14-15 prill, 2018

13°C | 26°C

15 DEN

EDITORIAL

**Motorët e
kotësirave
tona**



A jemi ne ata që imponojmë kurs zhvillimi në rubikonin gjeopolitik, apo jemi thjeshtë statist që presim se kah do të fryjnë elikat e erërave, për të rimarrë pastaj ndonjë pozicion post-festum? Kësaj pyetjeje duhet t'i përgjigjet ndonjë institut i yni në fushën e politikës e diplomacisë, që po mungon me ndikimin dhe rezeztimin e ideve dhe studimeve kompetente. U bëmë gazi i botës duke u përpëlitur në ethet e padurimit çka po na thotë filan analisti i X institutit ndërkombëtar dhe merremi pastaj disa ditë me analizat e tij, duke... Fq.2

GLOBI

**Kompromise
rreth sulmeve
mbi Sirinë**

Fq.15

RAJON

**Një konflikt
në mëngjes
që të mund
ta zgjidhin
pasdite**

Fq.14



TREGTIA E JASHTME E MAQEDONISË

GJERMANIA, PARTNER KRYESOR

Gjermania mbetet tregu kryesor eksportues i Maqedonisë me afër 2.4 miliardë eksport në vitin e kaluar, kurse Bullgaria me vlerë prej 293 milionë euro renditet në vendin e dytë ku eksportojmë më shumë prodhime. Kosova renditet në vendin e katërt, me një vlerë prej afër 200 milionë euro Fq.7

Motoçiklistët bëjnë kërdi në komunikacion

Shkup, 13 prill - Ashtu siç arinjtë kur zgjohen nga gjumi i thellë dimëror, po ashtu edhe motoçiklistët me ngrohjen e kohës janë shtuar në komunikacionin rrugor në vend. Përderisa të parët në masë të madhe e respektojnë Ligjin e natyrës, vozitësit e motoçikletave fare pak ju përmbahen rregullave të komunikacionit. Faktin se motoçiklistit dita ditës po shndërrohen në rrezik potencial për qarkulluesit në komu-

nikacion, e shpjegon fakti se në muajin mars - nëpër rrugët e Shkupit janë shkaktuar dyfish më tepër aksidente nga motoçiklistët se sa gjatë dy muajve të parë të këtij viti. "Në janar të këtij viti, në rajonin e Shkupit nga ana e motoçiklistëve, si kategori në vete e komunikacionit rrugor, janë shkaktuar dy aksidente, me çka vozitësit kanë marrë lëndime të rënda trupore. Ky numër... Fq.5



EDITORIAL

MOTORËT E
KOTËSIRAVE TONA

Emin AZEMI

Si duket po vazhdon ende koha e kronistëve të shek.18 e 19, të cilët dërgonin në metropolet tyre impresionet udhëpërshkrues pasi kishin kaluar një kohë nëpër viset tona ekzotike...

A jemi ne ata që imponojmë kurs zhvillimi në rubikonin gjeopolitik, apo jemi thjeshtë statist që presim se kah do të fryjnë elikat e erërave, për të rimarrë pastaj ndonjë pozicion post-festum?

Kësaj pyetjeje duhet t'i përgjigjet ndonjë institut i yni në fushën e politikës e diplomacisë, që po mungon me ndikimin dhe rrezatimin e ideve dhe studimeve kompetente. U bëjmë gazi i botës duke u përpëlitur në ethet e padurimit çka po na thotë filan analisti i X institutit ndërkombëtar dhe merremi pastaj disa ditë me analizat e tij, duke i shitur shpesh edhe si "tonat".

Të kesh kaq shumë universitete e kaq shumë tituj akademikë, të shpërndarë gjithandë hapësirës shqiptare, dhe të mos mundësh të formosh një institut të hajrit, që do të merrej me analiza e studime të rrjedhave politike e gjeostrategjike këtu afër nesh dhe pak më larg se ne, flet, jo vetëm për mosgatishmërinë e sistemimit të dijeve brenda një formati të organizuar, por edhe për prirjen që të tregojmë varshmëri të skajshme nga "fusnotat" e importuara në arenën e gjerë të luftërave të ndryshme speciale, që te ne përkthehen si "mendime të pavarura". Diplomatat dhe gazetarët e huaj, që rrotullohen këndej pari, e shohin të zitë e ullirit për të shkëputur një mendim të mençur në ndonjë copë gazetë dhe, në mungesë të një burimi më kompetent në fushën e analizave, jo rrallë kthehen me dilema dhe fjalitë e pambaruara, me mendime të shkëputa e jokompetente që i marrin këtu, i plotësojnë me vrojtme të tyre, që shpesh qëllojnë të jenë të karakterizuara me eklektizëm idesh e pikëpamjesh.

Si duket po vazhdon ende koha e kronistëve të shek. 18 e 19, të cilët dërgonin në metropolet tyre impresionet udhëpërshkrues pasi kishin kaluar një kohë nëpër viset tona ekzotike, duke veçuar karaktere e ngjyime etno-sociale të vendbanimeve të ndryshme. Në këto impresione zakonisht zinin vend doket e zakonet tona, mënyra e jetës, stili i veshjes dhe ushqimit, kodi moral e zakonor dhe të gjitha këto përbënin një vëzhgim të detajuar të frymës dhe kontekstit historik e social të banorëve të këtyre viseve.

Por, në shek. 18 e 19 mungonin shkollat shqipe, mungonin mediat dhe intelektualët dhe ishte e vetëkuptueshme jehona e kronikave europiane mbi realitetin e atëhershëm, i cili pasqyrohej ashtu siç e "fotografonin" të huajt. Një kapitull i dhimbshëm i kësaj jehone madje kaluar edhe nëpër Beograd, i cili një kohë bukur të gjatë kishte shërbyer si adresë-kontakt për njohjen e shqiptarëve. Prandaj, qysh nga ato kohë e kishin burimin shpifjet dhe stereotipat parargjyqese për "shqiptarët me bisht" që me lehtësi ishin transferuar edhe në një pjesë të publikut të paimformuar europian.

Tani kur kemi një realitet krejtësisht tjetër, kur etja për të hapur universitete dhe për të fotokopjuar diploma është shndërruar në sport kombëtar, po ndodhë pikërisht mjerimi që të mos arrijmë të akumulujmë dijet kompetente në kuadër të një instituti që do të zëvendësonte gjithë "shkencën e gjithologjisë" që po përhapet me të madhe nëpër portale e rrjetet sociale dhe për rrjedhojë asnjë europian apo amerikan që mundohet të kuptojë pak më thellë se çka po ndodhë këtu e ka vështirë të veçojë një mendim të pjekur, sepse edhe ato pak që janë, treten në zhurmën e madhe të "motorëve" të kotësirave tona.

ZBULIM EPOKAL NË KUMANOVË!

"Institucionet përkatëse kanë nis hetimet për ca individ që i kanë të falsifikuara diplomat universitare dhe titujt e tjerë të lartë shkencor! Vallë ka shqiptarë që nuk e ka të qartë se qyteti ynë është i mbushur përplot me njerëz që brenda natës janë stolitur me titujt të lartë shkencor, edhe pse shumë prej tyre nuk i kanë valide as diplomat të shkollave të mesme? Bile, personalisht njoh disa ngelafça të dikurshëm që kanë titujt të lartë shkencor e që falë tyre gëzojnë pozita të larta udhëheqëse. Sot në Kumanovë është problem të gjes një mjeshtër apo një punëtor krahu, sesa për tituj shkencor 'dr', 'mr', 'kr'..., kemi suficit si asgjë tjetër!", shkruan në profilin e tij në Facebook, dr.Selver Jashari.



JUGOSLLAVIA, ISA MUSTAFA DHE FIÇA

"Po thonë që Isa Mustafa është mirë më shnet dhe se e ka ndërmend të largohet nga politika. Këto dy lajme janë të mira. Largimi i Isa Mustafës nga politika shënon fundin e Jugosllavisë në Kosovë. Nuk po them që Isa Mustafa e ka promovuar Jugosllavinë. Por, ata që e kanë votuar apo përkrahë në çfarëdo mënyre, nëpërmes Isa Mustafës e kanë parë Jugosllavinë. Keni mund shpesh t'i dëgjoni përkrahësit e Isës, zakonisht gjeneratat e vjetra, tuj thanë: Hej, ky edhe atëherë (demek në vaktin e Jugosllavisë) u konë funksioner. Isa Mustafa është një lloj prodhimi jugosllav dhe ka shumë ngjajshmëri me një prodhim tjetër: Fiçën. Isa dhe Fiça kanë shumë karakteristika të përbashkëta. Psh. janë të vegjël, janë ekonomik se harxhojnë pak, qëndrojnë shumë, mirëmbahen lehtë, dhe mbi të gjitha, qojnë randë. Isa dhe Fiça kurrë nuk t'kanë lanë n'loq. Veç asht dashtë me dijtë qysh me ju grahë. Kanë qenë për çdo stinë.



Edhe ni kusheri i jemi e ka pasë ni herë ni Fiçë. Ka 5 veta i hypshmi Fiçës. Ngul përpjetë na qitke te Podina, n'maje t'ni kodrës ku shkojshim me lujtë futboll. Nime gjimjoke pi gazepit, ama na qojke te veni. Edhe Isës, sikur Fiçës, shpesh i kanë hypë katër vetë: Hashimi, Kadria, Ademi, Samia... Këta janë ndërru ka niherë kurse Hashimi ni kohë nuk i ka zhdryp hiq. Ama, edhe Isa asht majtë si burrat. Edhepse Isa nuk është anku kurr, hiq lehtë nuk e ka pasë. Nuk është lehtë me i shërby gjithë atyre regjimeve, qeverive dhe individëve për me fitu veq për veti. Deri sot veq Isa ka mujtë me dalë në pension 'pa therrë në këmbë'. Zoti i dhashtë shnet se boll ka hjekë", shkruan në profilin e tij në FB, publicisti nga Londra, Daut Dauti.

ATA MËRZITEN VETËM PËR SASINË DHE LLOJIN E MISHIT

"Nëse pushtetarët do të vendosin që të mos aktrojnë në përvjetorë të betejave të UÇK-së, përmbajtja e fjalimeve të tyre do të ndryshonte drastikisht. "Jemi krenar kur kujtojmë betejën e lavdishme të Koshares", është fjalia e famshme që do të hiqej nga fjalimi. Do të zëvendësohej me këtë: Ndihehi të nderuar kur shohim para vetës tavolinën e mbushur me mish. Ata nuk mërziten për faktin që familja e Agim Ramadanit ka dëshirë ta posedojë një mirënjohje për ta kujtuar Agimin. Ata mërziten vetëm për sasinë dhe llojin e mishit në tavolinat e tyre. Mërziten edhe për një gjë tjetër: Duan të kenë edhe para për t'i dhënë bakshish orkestrës. Ndihehi krenar kur e bëjnë këtë", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, gazetari Parim Olluri.



MEDIACitate

Bejtush Gashi,
ministër i ri i
Punëve të
Brendshme

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka emëruar Bejtush Gashin, ministër të Punëve të Brendshme. Në një postim në Facebook, kryeministri Haradinaj, ka shkruar se "ai i sjell qeverisjes së vendit një cilësi të re dhe një përvojë të madhe në këtë fushë të rëndësishme së veçantë për vendin". Bejtush Gashi ka qenë zëvendësministër në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gashi është emëruar në këtë post pas dorëheqjes së ministrit, Flamur Sefaj. Dorëheqjen e Sefajt paraprakisht e kishte kërkuar kryeministri Ramush Haradinaj, pas deportimit të gjashtë shtetasve turq për në Turqi, pa dijeninë e tij.

(REL, 13 prill)

"Vendime të
dhimbshme"

Kancelarja gjermane, Angela Merkel deklaroi se mirëpret takimin me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, dhe shprehur bindjen se ky takim do t'i kontribuojë gjetjes së zgjidhjes për çështjen e Kosovës, pavarësisht sa e vështirë të jetë, transmeton Koha.net raportimin e medieve serbe. Po ashtu bëhet e ditur se Vuçiq, ka paralajmëruar se do të marrë vendime të dhimbshme dhe të rënda në të ardhmen, nëse Serbia dëshiron të jetë pjesë e Bashkimit Europian. Në një paraqitje të përbashkët kancelaria Merkel tha se për Gjermaninë në BE kanë rëndësi zhvillimet në Ballkanin Perëndimor, ndërsa paralajmëroi samitin e Sofjes në muajin maj, e më vonë edhe Konferencën e formatit të Berlinit në Londër. Ajo tha se Serbia ka rol kyç sa i përket Kosovës dhe Bosnjës e Hercegovinës dhe prandaj ka rëndësi të kemi shkëmbime intensive dhe të afërta. Po ashtu lavdëroi reformat e bëra në Serbi. Vuçiq, ndërkaq, u shpreh se Serbia ndjek me kujdes dhe dëshiron të dëgjojë qëndrimet e Merkel. Ai ripërsëriti se çfarëdo konflikti në Ballkan do t'i kthente pas vendet tona për 100 vjet pas.

(KOHA Ditore, 13 prill)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

Çka është "lulja kufomë"?

Lulja më e madhe në botë e ka origjinën nga pyjet tropikale të Sumatras në Indonezi. E megjithatë kultivohet nëpër kopshte botanike dhe nga koleksionistë privatë në të gjithë botën. Emri shkencor i kësaj luleje është "Amorphophallus titanum" dhe është bima që prodhon lulen më të madhe në botë. Disa e quajnë unaza gjigande, por indonezianët e quajnë "lulja kufomë", sepse përhap një aromë

të pakëndshme të ngjashme me mishin e kalbur. Lulja kufomë i kalon 2 metra lartësi, mund të arrijë edhe deri në 1 metër gjerësi dhe të peshojë 75 kg.

Nuk mund të pllënohet vetë, kështu që tërheq bletët dhe insekte të tjera që jetojnë me kafshë të ngordhura. Në mjedisin natyror ata që luajnë këtë rol janë kafshët që transportojnë polenin nga një lule në tjetër. Për tri ditë lulja prishet dhe kalbet duke lënë vetëm një masë të zezë dhe xhelatinoze.

Bogov sugjeron se do të ishte më mirë që Qeveria të koncentrohet në tatimin e segmenteve që deri tani nuk u janë nënshtruar tatimit. Edhe më shumë që edhe Maqedonia njëjtë si edhe shtetet e rajonit, kanë problem me ekonominë ilegale

POLITIKAT MONETARE TË QEVERISË

TË TATIMOHEN SEGMENTET QË DERI TANI NUK JANË PËRFSHIRË



Ohër, 13 prill - Përmirësimet në disa aspekte në ekonominë e Maqedonisë të regjistruara në periudhën e fundit krijuan kushte për uljen e normës së interesit në 3 për qind. Banka e Evropës Qendrore ende i përmbahet politikës monetare e cila parashikon injektim të likuiditetit, me paralajmërim se me politikën e këitillë do të vazhdojnë deri në fund të vitit. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë do t'i ndjekë politikat monetare evropiane dhe në mënyrë adekuate me to do ta rregullojë të sajën. Këtë e theksoi guvernatori i BPRM-së Dimitar Bogov në konferencën për shtyp që u mbajt në kuadër të ditës së dytë të punës nga Konferenca vjetore që po mbahet në Ohër. Sa i përket politikës fiskale në vend dhe çështjes aktuale rreth planeve për vendosjen e tatimit progresiv, Bogov theksoi se politika fiskale është në ingerencë të Qeverisë, gjegjësisht se kjo është e drejtë e saj ekskluzive, gjithsesi edhe përgjegjësi.

"Politika monetare do t'i përshtatet çdo politike fiskale në mënyrë adekuate. Në qoftë se politika fiskale është më konservative, atëherë ka hapësirë që politika monetare të jetë më e relaksuar

dhe anasjelltas. Politikën tatimore nuk do ta komentoja, preja atje që ajo është gjithashtu kompetencë qeveritare", theksoi Bogov. Ai sugjeron se do të ishte më mirë që Qeveria të koncentrohet në tatimin e segmenteve që deri tani nuk u janë nënshtruar tatimit. Edhe më shumë që edhe Maqedonia njëjtë si edhe shtetet e rajonit, kanë problem me ekonominë ilegale, e cila është tejet e lartë, ndërsa ka hapësirë për përmirësim të financave publike pikërisht përmes përfshirjes së këtyre aktiviteteve ekonomike që nuk janë tatimuar.

Ekspertë financiar botërorë pjesëmarrës në tubimin në Ohër u përqendruan në çështjen aktua-

le rreth barrierave tregtare gjithnjë e më të pranishme që i sjellin ekonominë e fuqishme, me vlerësimin se çdo masë në kundërshtim me angazhimet për tregti të lirë negativisht do të ndikojë mbi rritjen e ekonomisë kombëtare dhe botërore në tërësi. "Lufta tregtare është lajm i keq. Kjo negativisht do të reflektojë mbi zhvillimin dhe rritjen ekonomike, në të gjithë ekonominë në korniza globale. Pasojat nga vendosja e barrierave eventuale tregtare do të jenë më të larta çmimet importuese, ndërsa e gjithë kjo do të jetë barrë mbi xhepin e qytetarëve. Efekt tjetër negativ do të ishte përkeqësimi i gjendjeve të përgjithshme të tregut të kapitalit

gjegjësisht ulje të besimit tek investuesit. Një luftë tregtare në afat më të gjatë negativisht do të reflektojë edhe mbi rritjen e prodhimit, duke e pasur parasysh se pikërisht tregtia e lirë është një prej determinatave që kushtëzojnë rritje ekonomike", tha Jan Smets, guvernatori i Bankës Qendrore të Belgjikës. Bas Baker, përfaqësues rezident rajonal i FMN-së për Evropën Qendrore dhe Lindore theksoi se nga fillimi i krizës ekonomike në kuadër të eurozonës, çdo parashikim që Fondi e ka dhënë lidhur me shkallën e zhvillimit të ekonomisë ka qenë më i ulët se ai paraprak.

"Rezultatet më të mira të shë-

nuara në eurozonë të regjistruara vitin e fundit ishin rezultat pikërisht i përfundimit të këmbimit tregtar botëror. Këmbimi i fuqishëm tregtar në korniza botërore sjell progres ekonomik, si në korniza globale, ashtu edhe në korniza të eurozonës. Është e qartë se në kushte të ngadalësimit të shpejtë të këmbimit tregtar nuk mund të priten parametra pozitive ekonomike", tha Baker. Në kuadër të Konferencës vjetore u mbajtën dy panel-diskutime, prej të cilëve njëri iu kushtua ciklit të ri global dhe normalizimit të politikës monetare, ndërsa i dyti rrjedhave kapitale - pikëpamjeve dhe rreziqeve të rajonit. Në takimin në Ohër morën pjesë përfaqësues të bankave qendrore të shteteve të BE-së dhe më gjerë, të Bankës të Evropës Qendrore, të institucioneve financiare dhe shtetërore, si dhe profesorë të institucioneve akademike nga më shumë shtete. Konferenca paraqet mundësi e shkëlqyeshme për këmbimin e përvojave me përfaqësuesit e bashkësisë më të gjerë ndërkombëtare për çështje kyçe nga sfera e makroekonomisë, politikës monetare dhe stabilitetit financiar, si për përfaqësuesit e BPRM-së, ashtu edhe për bankat vendore dhe institucionet e tjera financiare. Me konferencën në Ohër shënohet përvjetori nga pavarësimi monetar i Republikës së Maqedonisë.

FILLON PARAQITJA E DËSHMIVE MATERIALE

"Tenderët" do të vazhdojnë më 14 maj

Shkup, 13 prill - Gjykimi për lëndën "Tenderët" të PSP-së në të cilën e akuzuar e parë është ish-ministrja e Kulturës, Elizabeta Kançeska-Milevska, do të vazhdojë më 14 maj me paraqitjen e dëshmive materiale. Në seancën e djeshme u dëgjuan pesë biseda telefonike në prani të opinionit. Nga bisedat, katër janë bërë në vitin 2011 dhe në to më shpesh bisedojnë ish-ministrja e Kulturës, Elizabeta Kançeska-Milevska dhe ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakieski, ndërsa biseda e pestë është e vitit 2013 mes Kançeska Milevskës dhe ish-ministres së Punëve të Brendshme, Gordana Jankulovska. Në bisedën e parë që u prezantua, krahas Kançeska-Milevskës dhe Janakieskit, merr pjesë edhe drejtori i NN "Beton" nga Shiptipi, Ilija Prestilski. Në bisedë, Kançeska Milevska i informon Ja-

nakieskin dhe Prestilskin se "nesër do të shpallet tenderi", por, siç thekson, "në të është cekur gjithçka që atë ta fitojë Betoni". Thekson se do ta shtyjnë punën që të mos ketë stagnim dhe se atë ditë i ishin transferuar 48 deri 49 milionë denarë. I thotë "shtyni punën sikur gjithçka të jetë në rregull", ndërsa paraprakisht i thotë se do të duhet të shpallet tender i ri sepse gjithçka është shtetur me aneksin. Në bisedën e dytë mes Kançeska Milevskës dhe Janakieskit, ajo e informon Janakieskin se nuk ka denar për t'i paguar dhe se duhet me ribalancin të sigurohen mjete, ndërkaq ndaj kësaj Janakieski i thotë "t'i shesim rrobat e tua për t'u ndihmuar". Në bisedën e tretë mes Kançeska Milevskës dhe Janakieskit, ajo e informon se sa e ka nervozuar Ilija, të cilin, siç thotë, nuk ka mundur ta durojë aspak -

"më vjen t'ia ngulë thikën deri në fund, ndërsa lcen më vjen ta hedh në Vardar". E informon se ende nuk kanë dalë nga, siç thotë, "ana e cila shihet prej teje", ndërsa Janakieski i thotë se "nesër do të dalin, ndërkaq nëse jo, do t'ua shtyjë skelën". Në bisedën e katërt sërish mes Kançeska Milevskës dhe Janakieskit, ish-ministrja e Kulturës i thotë Janakieskit se "Ilija ka luajtur dhe mendon se ajo ia ka thirrur policinë, i thotë se nuk mund ta durojë fare". Thekson se i ka paguar 50 milionë, ndërsa për 20 milionë e tjera do të duhet të gjendet sepse nuk i ka paratë dhe do të duhet ta presë edhe një muaj. Ndaj kësaj Janakieski i përgjigjet se do të duhet ta presë. Biseda e pestë është mes Gordana Jankulovskës dhe Elizabeta Kançeska Milevskës në vitin 2013, në të cilën ish-ministrja e Kulturës e infor-



mon Jankulovskën se është paraqitur një farë Nikollçe Cvetanovski nga SPB Manastir i cili ia ka kërkuar dokumentet për ndërtimin e Muzeut të VMRO-së. Në bisedën e ndërsjellë informohet nëse duhet menjëherë t'ia japë nëse vjen, apo, ndërkaq, duhet t'i thotë se duhet të presë që t'i grumbullojë, ndërsa ndërkohë ka kërkuar nga ish-ministrja e Punëve të Brendshme të kontrollojë se për kë bëhet fjalë dhe nëse është

"ndonjë prej komunistëve". Atëherë ministrja e Punëve të Brendshme e këshillon nëse e merr urdhrin, t'i thotë se i duhet kohë për t'i mbledhur dokumentet dhe të mos ia japë menjëherë Nikollçe Cvetanovskit, ndërsa ndërkohë, siç thotë, do të kontrollojë se kush është ai dhe për çka bëhet fjalë. Lënda "Tenderët" ka të bëjë me zbatimin e punëve ndërtimore në Muzeun e Luftës së Maqedonisë në Shkup.

"Në përgjithësi, edhe pse realizimi i këtij Plani nuk mund të shprehet në përqindje për shkak të kualitetit të disa masave, janë tejkalar pritjet më optimiste dhe shkalla e realizimit është mbi 90 për qind. nga gjithsej 103 masa më pak se 10 nuk janë realizuar", tha Osmani

OSMANI PRET REKOMANDIM TË PASTËR

ËSHTË REALIZUAR MBI 90 PËR QIND E PLANI 3-6-9



Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 13 prill - Maqedonia ka arritur të dorëzojë axhendë jashtëzakonisht të volitshme në nëntë muajt e fundit dhe sërish është kthyer në rrugën evropiane. Kjo është porositja që zëvendëskryeministrit për Çështje Evropiane Bujar Osmanit i është transmetuar në bisedimet me përfaqësues të Komisionit Evropian gjatë vizitës së djeshme në Bruksel. Ai ka theksuar se Plani 3-6-9 është realizuar mbi 90 për qind dhe pret që Komisioni Evropian në raportin e tij për progresin në rrugën drejt BE-së për vendin të jetë më i mirë deri më tani dhe të përmbajë rekomandim të pastër për fillimin e negociatave inkuadruese. "Në përgjithësi, edhe pse realizimi i këtij Plani nuk mund të shprehet në përqindje për shkak të kualitetit të disa masave, janë tejkalar pritjet më optimiste dhe shkalla e realizimit është mbi 90 për qind. nga gjithsej 103 masa më pak se 10 nuk janë realizuar", tha Osmani. Ai ka theksuar se reformat nuk mbesin këtu, me përfundimin e Planit 3-6-9, por do të vazhdojnë edhe më tej, konform gjatë nismave udhëheqëse në Strategjinë e Komisionit Evropian për Zgjerim 20125 dhe sugjerimet në raportin e KE-së që do të publikohet më 17 prill. Sipas tij, valorizimi i vërtetë i këtij suksesi do të paraqesë



LIGJI I SHQIPES, THIRRJE IVANOVIT

Në pyetjen e gazetarëve për ligjin e përdorimit të gjuhëve, i cili për të është miratuar sepse tre herë e ka marrë përkrahjen në parlament, Bujar Osmani i bëri thirrje presidentit Ivanov, siç tha, ta shfrytëzojë mundësinë dhe në ditët në vijim ta luajë rolin e faktorit koheziv në shtet. Shprehu bindje se ligji do të zbatohet, dhe se presin së pari vendim nga Ivanov.

edhe zgjidhjen e emrit me Greqinë, dhen përmes fillimit të negociatave me BE-në edhe më shumë të rritet kursi reformues i shtetit, ndërsa në drejtim të arritjes së shoqërisë prosperuese.

Osmani e përhëndeti edhe kthimin e opozitës në Parlament, e cila i ka mbështetur një pjesë të ligjeve reformuese. Për atë si është siguruar mbështetja e opozitës për miratimin e ligjeve reformuese me shumicë prej dy të tretave, Osmani tha se kjo është arritur me pranimin e vërejtjeve të dhëna nga opozita. "Vendosëm standard të ri në miratimin e ligjeve. Asnjëherë nuk ka pasur një inkluzivitet të tillë dhe transparencë në miratimin e disa ligjeve përmes përfshirjes së sekto-

rit joqeveritar, të opozitës, madje dhe u angazhuam se edhe ligjet të cilat nuk kërkojnë shumicë të dy të tretave nuk do t'i miratojmë derisa nuk marrin pëlqim nga opozita (ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve), se tani është koha për konsensus shtetëror. Ky nuk është projekt i asnjë Qeverie dhe të asnjë parti politike por projekt të cilin e kërkojnë qytetarët e RM-së, ndërsa shumica e madhe janë për hyrje në BE dhe në NATO", tha Osmani. Për këtë është siguruar mbështetja nga opozita për miratimin e ligjeve reformuese me shumicë prej dy të tretave, osmani tha se kjo është arritur me pranimin e vërejtjeve të dhëna nga opozita. Lidhur me akuzat nga ana e VMRO-DOMNE-së opozitare se

gjoja ai i ka penguar zbatimin e planit për reforma dhe se për atë la pasur marrëveshje me shefin e diplomacisë shqiptare Ditmir Bushati, Osmani tha se bëhet fjalë për deklarata qesharake, në të cilën nuk beson as vetë opozita. "Nuk mund ta kuptoj shqetësimin e tyre me kërkesë të armiqësisë ndaj shqiptarëve, ndërtimin e imazhit të tyre politik përmes ndjenjës antishqiptare. U tregua për to se është shkatërruese për partinë dhe shtetin dhe vazhdojnë me narrativën e njëjtë. Gjithmonë disa shqiptarë janë fajtorë për çështjet të cilat nuk kanë lidhje me çështjet politike. Ajo nuk ka logjikë sepse Plani 3-6-9 është fëmijë i imi politik të cilën e krijova dhe e rrita së bashku me kolegët në ministritë dhe Qeveri. Çdo ditë e prezantojmë, njerëzit thonë se edhe nga frigoriferi dalim për shkak të kërkesave të përditshme të Qeverisë të nxiten ministrat më shpejtë t'i realizojnë masat. Ashtu që nuk ndjej nevojë të sqaroj. Për mua më e rëndësishme është se Plani i tejkaloj edhe pritjet e mia. Këtu ka 90 për qind, por unë them 100 për qind, sepse thelbi i planit është realizuar. Maqedonia është kthyer në rrugën evropiane, Maqedonia është valorizuar si tregim pozitiv në rajon i cili reflekton brenda dhe në rajon, atë presim ta thotë edhe KE-ja", tha Osmani. Sipas tij, akuzat e tilla, i ngajjnë kuzhinës së madhe ruse për shqiptarë të mëdhenj.

ZHBLLOKOHEN KONKURSET, ANËTARË TË RINJ NË KËSHILLA

Ky është prej 5 konkurseve që shpallet i pari këtë vit, zakonisht në fund të muajit mars, por për shkak të mandatit të përfunduar të anëtarëve të Këshillit për ndarjen e çmimit në Departamentin për ndarjen e çmimeve shtetërore në Ministrinë e Kulturës bëjnë me dije se konkursi do të shpallet në fillimin e javës së ardhshme

Mbaron pritja për "Nënë Terezën"

prej pesë konkurseve që shpallet i pari këtë vit, zakonisht në fund të muajit mars, por për shkak të mandatit të përfunduar të anëtarëve të Këshillit për ndarjen e çmimit, në Departamentin për ndarjen e çmimeve shtetërore në Ministrinë e Kulturës bëjnë me dije se konkursi do të shpallet në fillimin e javës së ardhshme. Bllokimi i punës në Komisionin parlamentar të zgjedhjeve dhe emërimeve vitin e kaluar solli dështimin e disa konkurseve, si "23 Tetori", "Mito Haxhi Vasiliev Jamin" (21 dhjetor). Për të dy këto çmime, i pari për arritje në sferën e shkencës, kulturës, arsimit, mbrojtjes së interesave shtetërore dhe promovimit të prioritetëve shtetërore, vlerave dhe trashëgimisë kulturore-historike të Maqedonisë dhe i dyti për kontribut në publici-

stikë dhe gazetari nuk u ndanë pasi që se konkurset nuk arritën të shpallen brenda afateve ligjore.

"Anëtarët e këshillit për ndarjen e çmimit Nënë Tereza u emëruan dhe data e përfundimit të të konkursit do të shtyhet deri në mes të muajit maj, periudhë kjo kur duhet të dorëzohen propozimet për dhënien e këtij çmimi. Çështja me mandatet e skaduara të anëtarëve të thujtës të gjitha këshillave është zgjidhur, pas emërimeve të miratuara në Parlament", thonë nga Departamenti i çmimeve shtetërore. Çmimi shtetëror "Nënë Tereza", është një prej çmimeve më të reja dhe ndahet që prej vitit 2006, më 26 gusht, në ditën e lindjes së humanistes nga Shkupi, me motivacionin për arritje në fuqishën e humanitetit, solidaritetit

njerëzor dhe për nxitjen dhe avancimin e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit mes bashkësive, kulturave dhe religjioneve, me shpërblim në një vlerë sa pesë paga mujore mesatare. Ministria e Kulturës disa kohë më parë ka lënë të kuptohet se këtë vit lista me çmimet shtetërore duhet të ndryshojë, me heqjen, apo edhe ripozicionimin e çmimeve shtetërore aktuale. Shkak u bë anulimi i çmimit "23 Tetori", ose festës së VMRO-DPMNE, për shkak të mosfunksionimit të Këshillit për ndarjen e çmimit, por nga Ministria e Kulturës paralajmëruan debate publike lidhur me ndryshime në çmimet shtetërore. Nga pjesa shqiptare vazhdimisht është kërkuar ndryshimi i profilit monoetnik të tërësisë së çmimeve shtetërore, pasi pjesa më e madhe e

tyre, e figurave apo datave që janë të rëndësishme vetëm për historinë dhe kulturën maqedonase. Ankesa ka pasur edhe nga fituesit e këtyre çmimeve, të cilët kanë kërkuar që të ndryshojë edhe rëndësia e secilit çmimit dhe rrjedhimisht edhe benefitet që përfiton marrësi i tyre. Prej disa muajsh në grupet e punës të ngritura në Ministria e Kulturës është debatuar për korrektimet që duhet të pësojnë jo vetëm çmimet shtetërore, por edhe vetë Ligjin për çmimet shtetërore, i cili për herë të fundit u ndryshua dhe plotësua në vitin 2012. Ndryshimeve pritet t'i paraprijë një debat publik për legjislativën në kulturë në përgjithësi, ku pas korrektimeve të Ligjit për Kulturën, do të reformohen edhe ligje të tjera.

Koha Evis HALILI

Shkup, 13 prill - Me më shumë se dy javë vonësë, Ministria e Kulturës do të shpallë konkursin për çmimin shtetëror "Nënë Tereza". Ky është

Pamjet e përditshme dhe praktika e deritanishme ka vërtetuar se në vendin tonë, motoçiklistët shumë pak i respektojnë detyrimet ligjore dhe si pasojë të mos përfilljes së rregullave të komunikacionit, ndodhin aksidentet e rënda, ku fatkeqësisht ka edhe pasoja në njerëz

VOZITËSIT E RINJ NUK PËRFILLEN E AS QË PËRFILLIN

MOTOÇIKLISTËT BËJNË KËRDI NË KOMUNIKACION



Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 13 prill - Ashtu siç arinjtë kur zgjohen nga gjumi i thellë dimëror, po ashtu edhe motoçiklistët me ngrohjen e kohës janë shtuar në komunikacionin rrugor në vend. Përdërisa të parët në masë të madhe e respektojnë Ligjin e natyrës, vozitësit e motoçikletave fare pak ju përmbahen rregullave të komunikacionit. Faktin se motoçiklistët dita ditës po shndërrohen në rrezik potencial për qarkulluesit në komunikacion, e shpjegon fakti se në muajin mars-nëpër rrugët e Shkupit janë shkaktuar dyfish më tepër aksidente nga motoçiklistët se sa gjatë dy muajve të parë të këtij viti.

"Në janar të këtij viti, në rajonin e Shkupit nga ana e motoçiklistëve, si kategori në vete e komunikacionit rrugor, janë shkaktuar dy aksidente, me çka vozitësit kanë marrë lëndime të rënda trupore. Ky numër është shtuar në muajin shkurt, me çka në katër aksidente të shkaktuara nga motoçiklistët, njëri prej tyre ka ndërruar jetë dhe tre tjerë kanë pësuar lëndime të rënda trupore. Për dallim nga fillimi i viti, gjatë muajit mars aksidentet në komunikacion, shkaktar të të cilëve kanë qenë motoçiklistët, janë trefishuar, respektivisht në dhjetë aksidente, katër motoçiklistë kanë kaluar me lëndime të rënda trupore, gjashtë prej tyre me lëndime të lehta dhe njëkohësisht është shkaktuar dëm i konsiderueshëm material", thonë nga Sektori për Punë të Brendshme Shkup.

Arsyeja më e shpeshtë e këtyre aksidentëve, siç njoftojnë nga policia e Shkupit, janë shpejtësia e madhe, mos respektimi i sinjalizimit rrugor, mos respektimi i parimit të kalimit të parë, tejkalimet e shpeshta, mano-

vrimet e ndryshme e kështu me radhë. Në bazë të Ligjit për siguri në komunikacion, drejtuesit e motoçikletave, pavarësisht fuqisë së tyre, gjatë pjesëmarrjes në komunikacion doemos duhet të mbajnë helmata mbrojtëse, gjegjësisht në rast se janë dy persona, atëherë edhe bashkudhëtari duhet ta ketë një helm të tillë. Pamjet e përditshme dhe praktika e deritanishme ka vërtetuar se në vendin tonë - motoçiklistët shumë pak i respektojnë detyrimet ligjore dhe si pasojë e mos përfilljes së rregullave të komunikacionit, ndodhin aksidentet e rënda, ku fatkeqësisht ka edhe pasoja në njerëz. Policia e Shkupit kur flet për gjendjen në terren dhe masat preventive për uljen e këtyre aksidentëve, njofton se gjatë muajve të kaluar ndaj motoçiklistëve janë shqiptuar

gjoha të ndryshme duke filluar nga 100 deri në 500 euro, përfshi edhe konfiskimin e motoçikletave. Prezenca periodike e motoçiklistë në komunikacion, sipas shumë shoferëve, paraqet edhe një fakt tjetër se pse ndodhin aksidentet gjatë kësaj periudhe. Vetëdija e ulët dhe mungesa e kulturës përfshi të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, ndikon që shumë drejtues të veturave mos t'i përfillin motoçiklistët fare dhe në këtë mënyrë - shpesh ndodhë përplasja mes tyre (zakonisht fajtorë janë motoçiklistët, megjithatë raportet policore tregojnë se edhe shoferët e veturave jo rrallë herë i godasin motoçiklistët). Sektori për komunikacion pranë MPB-së, njëherësh bën të ditur se kohëve të fundit janë shtuar patrullat policore për kontroll të motoçiklistëve, re-

spektivisht sipas tyre, një numër i konsiderueshëm i kësaj kategorie të vozitësve është përjashtuar nga komunikacioni. Rasti i fundit ku një motoçiklist e ndërroi jetë u regjistrua mëngjesin e së premtes. Në bazë të raportit ditor të SPB-Shkup, ngjarja ka ndodhur në lagjen Aerodrom të Shkupit, me çka një veturë e tipit "Mitsubishi", e kishte goditur për vdekje motoçiklistin.

Në rekomandimet e publikuara për siguri më të madhe të motoçiklistëve në komunikacion, Këshilli për Siguri në Komunikacion nënvizon se distanca mes motoçiklistëve dhe pjesëmarrësve tjetër në komunikacion duhet të respektohet, shpejtësia të kontrollohet dhe njëkohësisht paralelisht me helmata mbrojtëse, motoçiklistët të kenë të veshur jelek reflektues.

ÇARSHIA E SHKUPIT PISTË PËR MOTOÇIKLISTËT

Fotografia më reale e motoçiklistëve dhe veprimet e tyre të "tërbuara", më së mirë pasqyrohet në Çarshinë e Vjetër të Shkupit. Përdërisa në kohërat e mëhershme nëpër këtë kompleks historik qytetarët nuk kanë guxuar të ngasin as biçikletë, por vetë ta ecin atë, sot rrugicat e ngushta të Çarshisë së Shkupit janë shndërruar si mini pista për gara. Zhurma e madhe të cilët e shkaktojnë dhe shpejtësia e pakontrolluar shpesh ka qenë shkaktarë që shtyllat elektrike të vendosura përmes Çarshisë të pësojnë më së keqi. Për esnafët e moçëm të Çarshisë, kjo lëvizje e motoçiklistëve aspak nuk

kontribuon në ruajtjen e traditës dhe edukatës që e ka pasur ky kompleks, megjithatë mungesa institucionale, siç thonë at, e bën të veten. Kryetari i Esnafit të Çarshisë, Bejtulla Morina, kohë më parë për gazetën KOHA, theksoi se kanë kërkuar prezencë më të madhe të policisë në Çarshie, mirëpo përgjigja e ministrisë ka qenë se nuk disponojnë me kuadër të mjaftueshëm për shpërndarjen e nëpunësve policor edhe në Çarshi. Kësisoj, ai thotë se sigurimi i ri i Çarshisë që pritet të fillojë së shpejtë, do të rregullojë edhe çështjen e prezencës së motoçiklistëve.

KRONIKË

Rrahet tetovari, përfundon në spital

Të enjten mbrëma rreth orës 23 e 10 minuta, në Spitalin Klinik të Tetovës është sjellur 37 vjeçari G.M nga Tetova me plagë të në trup të shkaktuar me thikë. Pas marrjes së ndihmës së parë është dërguar në Klinikat e Shkupit. Sipas policisë, personi me iniciale G.M plagët i ka marrë në një rrahje që ka ndodhur në rrugën e Shtipit në Tetovë, ku dyshohet se kanë marrë pjesë edhe një 36 vjeçar me iniciale M.E po ashtu nga Tetovë. Të plagosurin në spital e kanë sjellur kalimtarët e rastit, kurse personi tjetër është larguar nga vendi i ngjarjes. Policia ka marrë masa për kapjen e personit tjetër të involvuar në këtë ngjarje.

Përfshihen nga zjarri dy vetura

58 vjeçari E.A nga fshati Banjicë i Gostivarit të enjten mbrëma rreth orës 21 e 50 minuta ka denoncuar se vetura e tipit Ford Mondeo, me targa të Gostivarit pronë e N.A 27 vjeçar, poashtu nga Banjica, është përfshirë nga zjarri në pjesën e parme. Me intervenimin e kalimtarëve zjarri është lokalizuar. Po ashtu, një veturë tjetër e tipit Lançia është përfshirë nga zjarri në fshatin Grupçin afër xhamisë së fshatit. Me intervenimin e zjarrfikësve të Tetovës, zjarri është lokalizuar.

Aksidentohet 68 vjeçari në Tetovë

Të enjten rreth orës 9 në rrugën e Lubotenit në Tetovë, veturë e tipit Opel Astra, me targa të Tetovës e drejtuar nga 59 vjeçari A.A nga fshati Pallçishtë, ka aksidentuar këmbësorin 68 vjeçar me iniciale SH.I. Nga ky aksident, 68 vjeçari ka marrë lëndime trupore dhe pas marrjes së ndihmës së parë në Klinikën e Tetovës, është dërguar në Klinikat e Shkupit. Sipas informacioneve të para, shkak për këtë aksident ka qenë mospërshtatja e shpejtësisë. (U.H)

Paditet ish-kryetari i Radovishit

Strumicë, 13 prill - Policia ngriti padi penale për ish kryebashkiakun e Radovishit, Sashko Nikollov (39) për shkak të dyshimit se ka kryer vepër penale "keqpërdorim të pozitës dhe autorizimit zyrtar", kumtoi sot zëdhënësja e SPB Strumicë, Hrizan-tema Rendevska. Sipas saj, Nikollov në fillim të korrikut të vitit të kaluar ka vepruar në kundërshtim të akteve të komunës dhe ka nën-

shkruar urdhër për shfrytëzimin e veturës zyrtare "Pezho 528", pronë e Komunës së Radovishit, një personi i cili nuk ka qenë i punësuar në komunë për udhëtim në relacionin Radovish- Çinarxhik, Republika e Turqisë. "Më 22 korrik të vitit 2017, gjatë kthimit nga Republika e Turqisë, personi fizik me veturën ka shkaktuar një aksident rrugor në Republikën e Turqisë, me çka është

shkaktuar dëm material ndaj veturës së udhëtimit "Ford" në vlerë prej 43.000 denarëve. Pas arritjes në Republikën e Maqedonisë vetura "Pezho 528" menjëherë është dërguar për rregullim për çka është paguar 10.000 denarë në para të gatshme. Më vonë, është verifikuar edhe dëmtim tjetër i veturës në vlerë prej 20.487 denarëve, e cila ende nuk është sanuar", tha



zëdhënësja e SPB Strumicë, Hrizan-tema Rendevska në konferencën e sotme për media. Në këtë mënyrë i akuzuari i ka shkaktuar dëm buxhetit të komunës së Radovishit në vlerë prej 63.750 denarëve.

Mojsoski emërohet drejtor i Idrizovës

Shkup, 13 prill - Bobi Mojsoski është emëruar u.d. drejtor i Institucionit ndëshkues-përmirësues Idrizovë. Mojsoski është emëruar në seancën e fundit qeveritare. Ai vjen në vendin e Antonio Dimov, i cili në këtë pozitë ishte emëruar në shkurt të këtij muaji. Dimov mbetet në funksion derisa emërimi i pasardhësit të tij Mojsoski nuk publikohet në Gazetën zyrtare. Bobi Mojsoski deri më tani ishte drejtor i Agjencisë për Mbështetje të Sipërmarrjeve së Republikës së Maqedonisë. Mojsoski vjen nga Kërçova.

Qarkullimi në industri rritet për 14 për qind

Shkup, 13 prill - Qarkullimi në industri në shkurt, në krahasim me janarin e këtij viti është rritur për 1,2 për qind, ndërkaq krahasuar me shkurtin e vitit të kaluar për 7,4 për qind. Në dy muajt e parë të këtij viti, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, qarkullimi në industri është rritur për 14,1 për qind. Sipas grupeve kryesore industriale, qarkullimi i përgjithshëm në industri në shkurt të këtij viti, në krahasim me shkurtin e vitit të kaluar, shënon rritje tek "prodhimet intermediare, përveç energjisë" për 4,8 për qind, "prodhimet kapitale" për 10,8 për qind dhe "prodhimet e paqëndrueshme për konsum të gjerë" për 5,8 për qind, ndërsa rënie tek "prodhimet e qëndrueshme për konsum të gjerë" për 1,7 për qind. Qarkullimi në industri në tregun vendor, në periudhën janar - shkurt 2018, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, është rritur për 11,6 për qind, ndërsa në tregjet e huaja 14,2 për qind.

Konstituimi i organit më të lartë universitar, Senatit të UNT-së, sipas anëtarit të parë të Komisionit Verifikues të Mandateve, Lutfi Bina, është shenjë të qartë se Universiteti i ri po vendoset në shtylla të forta. Ndërkaq, për rektorin Aziz Pollozhani, me këtë po hapet një faqe të re në historinë e funksionimit të Universitetit

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 13 prill - Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup ka konstituuar të premten organin më të lartë të tij Senatit, në përbërjen e parë të anëtarëve me mandate katër vjeçare (2018-2022). Ky akt, i cili shënon hapin definitiv drejt themelimit të organeve bazuar në Statutin e Universitetit, pasoi dhjetë ditë pasi Parlamenti miratoi Statutin e UNT-së, ndërsa është në rrjedhë e sipër procedura për zgjedhjen e Rektorit të këtij institucioni. Prof.dr.Lutfi Bina anëtar i parë i Komisionit Verifikues të Mandateve të anëtarëve të Senatit propozuar nga Këshillat Shkencore-Mësimore të pesë fakulteteve, e konsideron konstituimin e Senatit si "shenjë të qartë se Universiteti i ri po vendoset në shtylla të forta". Ndërkaq, për ushtruesin e detyrës së rektorit të UNT-së, prof.dr. Aziz Pollozhani, Universiteti po hap një faqe të re në historinë e funksionimit të tij.

UNT nisi me punë në vitin akademik 2016/2017 dhe gjithë këtë kohë funksiononte me organe të përkohshme. "Konstituimi i Senatit, është shenjë se universiteti po vendoset në shtylla të forta. Pra plotësohet pjesa ligjore e themelimit të organeve, të cilat deri dje ishin të përkohshme, pasi edhe vetë UNT-ja ka qenë në fazën e themelimit. Falë punës dhe përkushtimit që është bërë nga të gjithë, sidomos nga ushtruesi i detyrës rektori

FILLON FAZA E VEPRIMIT ME STATUT DHE LIGJ

KONSTITUOHET SENATI I UNT-së



Aziz Pollozhani, po tejkalojmë edhe procedurat formale të konstituimit të këtij Universiteti, i cili premton që në të ardhmen të jetë një institucion tepër serioz", thotë Bina. Natyrisht, plotëson më tej ai, jam i lumtur me arritjen deri në këtë fazë të themelimit të një Senat i ri, bazuar në Statutin e Universitetit dhe Ligjin aktual të arsimit të lartë. "Besoj se tani e tutje të gjitha vendimet do të merren në baza demokratike dhe ligjore. Do të punojmë që këtij Universiteti ti jepim ngjyrat e një institucioni evropian, pse jo edhe i niveleve botërore. Ky nuk do të jete një universitet i mëhallës por i niveleve botërore", shprehet Bina, anëtar i vjetër i Senatit të UNT-së dhe profesor nga Fakulteti i Ndërtimtarisë. Në përbërjen e re të Senatit, sikurse kërkohet me Ligj, të gjithë anëtarët janë me titujt profesor ordinar dhe profesor inordinar,

për dallim prej përbërjes së Senatit të përkohshëm ku kishte edhe profesorë me thirrjet docent. Në Senatit e themeluar mbi Statutin e UNT-së, krahas profesorëve ka edhe përfaqësues të studentëve. Ushtruesi i detyrës së rektorit, Azizi Pollozhani, i cili sipas Ligjit në fuqi të arsimit të lartë është edhe kryesuesi i Senatit, thotë se me konstituimin e këtij organi madhor, UNT hap faktikisht një faqe të re. "Konsolidimi i Universitetit fillon me Senatit, si organ madhor ku sillen vendimet në përputhje me Ligjin dhe në vijim të kësaj edhe themelimi i të gjitha organeve tjera të Universitetit. Në bashkëpunim me Këshillat mësimore të fakulteteve jemi në procedurë për të realizuar gjithçka është në përputhje me Ligjin, sa i takon konsolidimit të plotë ligjor dhe statutit të këtij universiteti", shprehet Pollozhani.

UNT u themelua më 24 dhjetor 2015, kur Parlamenti i Maqedonisë miratoi Ligjin për themelimin e këtij universiteti, ndërsa nisi me punë më 27 tetor të vitit pasardhës (2016). Deri më 3 prill të këtij viti, Universiteti funksiononte me organe dhe Statut të përkohshëm, ndërsa pas miratimit të Statutit më 3 prill 2018 dhe konsolidimit të Senatit më 13 prill, faktikisht hapet një faqe e re e funksionimit të tij, tani më jo me organe dhe Statut të përkohshëm, por me organe dhe Statut fuqiptotë. Në pesë fakultetet e saj janë të punësuar deri tani 72 profesorë me të gjitha thirrjet shkencore, ndërsa UNT është në prite të marrjes së lejes për shpalljen edhe të 11 vendeve tjera të punës për kuadrot që për afatet kohore nuk mundën të pranohen në punë gjatë konkursit të rregullt që u shpall vitin e kaluar.

Rritet numri i turistëve

Shkup, 13 prill - Numri i turistëve në shkurt të këtij viti ishte 41.182, që është rritje për 11,7 për qind në muajin e njëjtë të vitit të kaluar. Është rritur edhe numri i bujtjeve për 11,8 për qind dhe në shkurt 2018 ai numër ka qenë

89.301. Sipas Entit shtetëror për statistika, numri i turistëve vendorë në shkurt 2018 në krahasim me shkurtin e vitit 2017 është rritur për 8,1 për qind, ndërsa i të huajve për 13,8 për qind. Numri i bujtjeve ndërkaq, i turistëve ven-

dorë është rritur për 25,4 për qind, ndërsa i bujtjeve të turistëve të huaj për 4,3. Numri i turistëve tregon rritje edhe në periudhën janar - shkurt 2018 në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja është 13

për qind ose tek turistët vendorë 6,3, ndërsa tek të huajt 17,4. Në këtë periudhë krahasuese është rritur edhe numri i bujtjeve, për 17,2 për qind - tek turistët vendorë për 17, ndërsa tek të huajt për 17,4.

Tre viktima për tre muaj në rajonin e Pollogut

Tetovë, 13 prill - Gjatë tre muajve të kaluar të këtij viti, në rajonin e Pollogut janë regjistruar 178 aksidente trafiku apo 28 më shumë në krahasim me tre muajt e parë të vitit 2017. Në aksidentet e sivjetshme ka patur tre viktima, ndërsa vitin e kaluar një viktimit në tre muajt e parë. Në mesin e

atyre që kanë humbur jetën kanë qenë dy bashkudhëtarë dhe një motorist. Shumica e aksidenteve apo 88 kanë ndodhur në lëvizje, 23 kanë qenë me vetura të parkuara, 36 dalje nga rruga, ndërsa 15 janë shkaktuar nga kafshët, kryesisht qentë endacak. Kështu bëjnë të ditur nga Sekto-

ri për Punë të Brendshme në Tetovë, në një raport dërguar mediave. Edhe këtë vit shkaktar i këtyre aksidenteve kanë qenë shpejtësia e lartë, apo mospërshtatja e shpejtësisë me kushtet në rrugë, më pas janë mos dhënies e përparësisë e kështu me radhë. Si ditë më kritike kur ka patur më

shumë aksidente ka qenë dita e enjte, më pas është dita e hënë dhe dita e shtunë. Pjesa më e madhe e aksidenteve kanë ndodhur në mes orës 16 dhe 18. Gjatë kësaj periudhë janë kontrolluar 12.528 vetura dhe vozitës, me ç'rast janë zbuluar 4193 shkelje të rregullave të komu-

nikacionit. Në tre muajt e parë të këtij viti janë zbuluar edhe 223 persona që kanë drejtuar makinën pa leje për qarkullim. Ndërkohë, për shkak të parregullive teknike, janë përjashtuar nga komunikacioni 203 vetura, ndërsa 153 kanë qenë me regjistrim të skaduar.

Gjermania mbetet tregu kryesor eksportues i Maqedonisë me afër 2.4 miliardë eksport në vitin e kaluar, kurse Bullgaria me vlerë prej 293 milionë euro renditet në vendin e dytë ku eksportojmë më shumë prodhime. Kosova renditet në vendin e katërt, me një vlerë prej afër 200 milionë euro

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 13 prill - Gjermania është partneri kryesor tregtar i Maqedonisë. Afër gjysma apo 47 për qind e eksportit të Maqedonisë shkon për Gjermani, ku dominojnë pjesët e industrisë automobilistike që prodhojnë në fabrikat e zonave të lira ekonomike. Të dhënat statistikore tregojnë se eksporti i tërësishëm i Maqedonisë në vitin 2017 ishte i vlefshëm afër 5 miliardë euro, ndërsa nga ana tjetër, importi në vitin e kaluar ishte i vlefshëm afër 6.8 miliardë euro.

FABRIKA XHONSON METI, EKSPORTUESI MË I MADH

Sipas këtyre treguesve del se Gjermania mbetet tregu kryesor eksportues i Maqedonisë me afër 2.4 miliardë eksport në vitin e kaluar. Në ekonominë më të fuqishme evropiane më së shumti eksportohen katalizatorët dhe pastruesit e gazrave të fabrikës Xhonson Meti të dedikuara për industrinë automobilistike që vjet arritën vlerën e shitjes jashtë prej 1.3 miliardë euro apo një e treta e totalit të eksportit vendor. Prodhimi i tretë më i eksportuar janë përçuesit për ndezje të fabrikës Drekslemajer në Kavadar, me vlerë prej afër 200 milion euro. Pasonjë tablotë dhe pllakat për shpërndarjen e rrymës me vlerë prej afër 93 milion euro. Në vendin e gjashtë të prodhimeve më të eksportuara renditen sediljet e Xhonson Kontroll që prodhohen

TREGTIA E JASHTME E MAQEDONISË

GJERMANIA, PARTNER KRYESOR



në Shtip me vlerë prej afër 80 milionë euro. Në Gjermani eksportohen edhe prodhime të ndryshme të tekstilit, verë, specia etj.

Bullgaria me vlerë prej 293 milion euro renditet në vendin e dytë ku eksportojmë më shumë prodhime. Në shtetin fqinj lindor në eksport dominojnë xehet, duhani dhe gypat e çelikut.

Në vendin e tretë sipas vlerës së eksportit me 219 milionë euro renditet Serbia ku kryesisht eksportojmë energji elektrike, ilaçet e Alkaloidit, prodhime të industrisë metalurgjike, rrush për konsum, domate të freskëta dhe ëmbëlsira industriale. Këto pesë prodhime përbëjnë afër 30 për qind të eksportit në Serbi, apo afër 70 milionë euro.

TREGU KOSOVAR I JEP 200 MILIONË EURO MAQEDONISË

Kosova renditet në vendin e katërt si tregu më i rëndësishëm tregtar ku plasohen prodhimet nga Maqedoni me një vlerë prej afër 200 milionë euro. Në vend të parë sipas vlerës së eksportit në Kosovë renditen karburantet e rafinerisë Okta me vlerë prej afër 20 milionë euro, ndërsa në vendin e dytë është çimentoja e fabrikës Usje me vlerë prej afër 13 milionë

euro. Në vendin e tretë me vlerën prej afër 8 milionë euro renditen prodhimet metalurgjike, ndërsa pason edhe karburanti i avionëve, apo kerozina me vlerë prej afër 7 milionë euro. Në Kosovë eksportohen edhe shufra çeliku, ëmbëlsira industriale të fabrikave Evropa, Vitaminka e Prilepit, etj, pemë dhe perime të freskëta, prodhime dhe përpunime të qumështit si qumështi, jogurti apo djathërat, etj.

Greqia është tregu i pestë më i rëndësishëm eksportues i Maqedonisë me 180 milionë euro ku më së shumti eksportojmë duhan, mermer, prodhime të tekstilit, mish qengji, prodhime të industrisë metalike, etj.

Nga ana tjetër, në vendin e parë lidhur me importin e prodhimeve renditet Gjermania me vlerë prej

803 milionë euro, në vendin e dytë është Britania e madhe me 690 milionë euro, ndërsa në vendin e tretë renditet Greqia me import prej 546 milionë euro. Nga Serbia importojmë mallra në vlerë prej 489 milionë euro, ndërsa nga Kina importojmë mallra në vlerë prej 392 milionë euro.

Në periudhën e kaluar në import dominojnë lëndët e para për fabrikat e huaja që punojnë në zonat e lira ekonomike si dhe derivatet e naftës dhe energjia elektrike. Në vitin e kaluar dominon platina me 630 milionë euro dhe palladiumi me 221 milionë euro që i shfrytëzojnë fabrika Xhonson Meti për prodhimin e katalizatorëve. Në vendin e dytë të prodhimeve më të importuara në Maqedoni me 670 milionë euro janë karburan-

tet e naftës që edhe nuk çudit duke llogaritur gati 390 mijë vetura që qarkullojnë në rrugët e Maqedonisë që harxhojnë naftë, benzinë dhe më pak gaz si karburant për ngasje. Në vendin e tretë sipas importit është industria metalike që në vitin 2017 ka importuar prodhime metalike dhe të çelikut në vlerë prej afër 510 milion euro që përdoren si lëndë e para nga industria metalike.

Ndryshe, analizat tregojnë se shumica e prodhimeve që Maqedonia eksporton jashtë janë lëndë të para ose gjysmë prodhime që në ndonjë shtet tjetër inkorporohen në prodhime të gatshme. Ndër 100 prodhimet që më së shumti eksportohen nga vendi ka fare pak prodhime të gatshme me fazë më të lartë të përpunimit ose prodhime për konsum final. Ndër to radhiten autobusët, barnat, këmbësorët dhe prodhimet e tjera të tekstilit, cigaret, ëmbëlsirat, ajvari, salsicet etj. Analiza e prodhimeve më të eksportuara nga Maqedonia, tregon se në gishta mund të numërohen prodhimet me fazë finale të përpunimit apo që janë të dedikuara për konsum final. Andaj, sfidë e vërtetë për ekonominë e Maqedonisë në periudhën e ardhshme mbetet zgjerimi i prodhimeve me krijimin e brendeve të reja, pasi edhe po të rritet eksporti apo prodhimtaria e prodhimeve që tani eksportohen, ato nuk do të sjellin ndonjë fitim të madh devizor nga eksporti për shtetin.

KRIJIMI I BRENDEVE TË REJA, SFIDA E RADHËS

Analizat tregojnë se shumica e prodhimeve që Maqedonia eksporton jashtë janë lëndë të para ose gjysmë prodhime që në ndonjë shtet tjetër inkorporohen në prodhime të gatshme. Ndër 100 prodhimet që më së shumti eksportohen nga vendi ka fare pak prodhime të gatshme me fazë më të lartë të përpunimit ose prodhime për konsum final. Ndër to radhiten autobusët, barnat, këmbësorët dhe prodhimet e tjera të tekstilit, cigaret, ëmbëlsirat, ajvari, salsicet etj. Analiza e prodhimeve më të

eksportuara nga Maqedonia, tregon se në gishta mund të numërohen prodhimet me fazë finale të përpunimit apo që janë të dedikuara për konsum final. Andaj, sfidë e vërtetë për ekonominë e Maqedonisë në periudhën e ardhshme mbetet zgjerimi i prodhimeve me krijimin e brendeve të reja, pasi edhe po të rritet eksporti apo prodhimtaria e prodhimeve që tani eksportohen, ato nuk do të sjellin ndonjë fitim të madh devizor nga eksporti për shtetin.

SHFUQIZOHET AKTAKUZA PËR VRASJEN E TRE POLICËVE NË HARAÇINË

PAS 18 VITESH, DINARICA ME SHOKË SHPALLET I PAFAJSHËM

Shkup, 13 prill - Gjykata Penale e Shkupit të premten për të dytën herë e shpalli aktgjykimin për vrasjen e tre policëve në janar të vitit 2000. Të akuzuarit Lirim Dinarica, Emrulla Emrullai, Ramiz Asani, Muça Bajrami, siç tha gjykatësja Lidija Trajkovska-Zimbovska, shpallen të pafajshëm nga akuzat për vrasjen e policëve Kirill Petrushevski, Aco Angellovski dhe Eroll Gotak. Nga hetimi i mëtutjeshëm ndërkohë janë liruar nga aktakuza

edhe tashmë të ndjerit Bashkim dhe Agim Asani. Ky proces gjyqësor ka zgjatuar 18 vite të plota, me çka i akuzuari i parë, tashmë i shpallur i pafajshëm, Lirim Dinarica, para ndërtesës së Gjykatës, tha se në mbrojtje të tyre kanë dëshmuar mbi 100 dëshmitarë, të cilët kanë vërtetuar se atë nuk kanë lidhje me rastin në fjalë. "Ndjej keqardhje se pse në shtetin tonë të Maqedonisë, më duhet ta theksoi se në burgje qëndrojnë njerëz të pafajshëm. Jo

vetëm për këtë rast. Ne i kaluam 18 vite torturë dhe maltretim përgjatë korridoreve të këtyre gjykatave dhe vetëm ne e dimë se çfarë kemi përjetuar", tha Dinarica. Vrasja e tre policëve saktësisht ka ndodhur më 11 janar të vitit 2000, në hyrje të fshatit Haraçinë. Rigjykimi i këtij procesi gjyqësor u bë për shkak se Gjykata e Apelit, me propozim të Prokurorisë Publike, e ktheu lëndën në shkallë të parë. Kështu që, me fillimin e rigjykit, listës së të dy-

shuarve ju shtua dhe i akuzuari Emrulla Emrullai, ndërsa procedura gjyqësore u ndërpre për Agim Asanin, i cili u në afërsi të Qendrës Tregtare "Ilinden", u vra në shkurt vitit 2007. Aktakuza e shfuqizuar të akuzuarit i ngarkonte se ndaj policëve të ndjerë kishin ngritur kurth pasi në drejtim të Haraçinës, ishin nisur për gjetjen e disa veturave të vjedhura. I akuzuari i parë, Lirim Dinarica, në fazë parahetimore, siç thuhet në vendimin gjyqësor, e ki-



shte pranuar veprën dhe kishte treguar detajisht mënyrën e organizimit të vrasjes së policëve, mirëpo pas paraqitjes në Gjykatë, i njëjti e ka ndryshuar deklaratën, me çka kishte shtuar se deklaratën e parë e kishte dhënë nën presionin e dhunës. (O.Xh)

DHUNA NË FAMILJE DOMINON KRONIKËN E ZEZË E POLLOGUT

GJENDJA EKONOMIKE, PASOJA EDHE NË DHUNËN FAMILJARE



Ajo që është më shqetësuese është se viktimat e dhunës nuk u shkojnë deri në fund proceseve gjyqësore dhe pas procedimit të padisë nga policia në gjykatë, gratë tërhiqen duke mos kërkuar që të ketë epilog gjyqësor. "Kjo për arsye se ata nuk kanë ku të kthehen, ndërsa strehimore në rajonin e Pollogut nuk ka", thotë Xhane Kreshova nga Forumi i Gruas në Tetovë

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 13 prill - Gjendja e rënduar ekonomike dhe sociale ka bërë që kohëve të fundit, përveç shumë dukurive negative që ndodhin në shoqërinë tonë, vend të posaçëm të ketë edhe dhuna në familje. Kështu thonë edhe organizatat që merren me këtë dukuri, të cilët ndajnë këtë shqetësim, duke sqaruar se një nga faktorët që ndikon në dhunën familje - është edhe aspekti social. Rastet e këtilla tashmë janë shëndërruar në përditshmëri në kronikën e zezë për rajonin e Tetovës, ku dominojnë rastet e dhunës ndaj anëtarëve të familjes, edhe pse në të kaluarën kryesisht dhuna ishte ndaj bashkëshorteve. "Është e evidente se në shumicën e rasteve, dhuna në familje shkaktohet për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike. Papunësia

është shumë e madhe në këto hapësira. Kërkesat janë të mëdha, kurse mundësitë janë të vogla për të përballuar gjithë këtë dinamikë në jetën e përditshme. Prandaj edhe shpërthen dhuna në familje si pasojë e kësaj", thotë Xhane Kreshova nga Forumi i Gruas në Tetovës. Por ajo që është më shqetësuese në këtë drejtim është se viktimat e dhunës nuk u shkojnë deri në fund proceseve gjyqësore dhe pas procedimit të padisë nga policia në gjykatë, gratë tërhiqen duke mos kërkuar që të ketë epilog gjyqësor. Kjo për arsye se ata nuk kanë ku të kthehen, ndërsa strehimore në rajonin e Pollogut nuk ka. "Brenda vitit kemi diku 40 viktima të dhunës në familje, të cilët kërkojnë ndihmë juridike në qendrën tonë. Prej tyre 20 raste marrin epilog gjyqësor, por gjysma tjetër tërheq padinë, sepse ajo nuk

ka se ku të shkojë, prandaj edhe vazhdon të jetojë me dhunuesin që është edhe më e rëndë. Poashtu mungesa e strehimores ka bërë viktimat të mos kenë mundësi se ku të shkojnë pas dhunës apo pas përfundimit të procesit gjyqësor. Një problem në vete është edhe mungesa e strehimores, të cilën ka vite që e kërkojmë, por nuk është duke u realizuar. Ne si organizatë kemi bërë kërkesa deri te Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, të cilët janë më të thirrur për këtë problematikë, ata jo që refuzojnë kërkesat tona, por vazhdimisht premtojnë se do të gjejnë në zgjidhje për këtë problematikë, dhe kjo çështje ka ngelur një çështje e hapur prandaj nuk mundësi t'ju dalim në ndihmë viktimave që pësojnë nga dhuna në familje", deklaroi Kreshova. Sipas udhëzimeve për masat që duhet të ndërmerren për

mbrojtjen e gruas nga dhuna në familje, parashihet hapja e sporteve të specializuara për mbrojtje nga të gjitha format e dhunës edhe atë nga një zyrë në çdo 10 mijë banorë. Qendra për ndihmë të viktimave nga përdhunimi, minimum 1 në 400 mijë banorë si dhe strehimore. Përndryshe, edhe gjatë ditës së sotme është regjistruar një rast u dhunës në familje. Sipas policisë, 72 vjeçarja me iniciale S.R nga fshati Vrapçisht i Gostivarit, dje ka denoncuar dhunë familjare të cilën më 7 prill ndaj e saj e ka ushtruar djali 46-vjeçarë me iniciale R.R. "Ditën e martë rreth orës 15:00 tek ata për vizitë ka ardhur vajza e 72-vjeçares, 41-vjeçarja me iniciale F.S me të cilën vëllai menjëherë ka filluar një zënkë verbale, ndërsa më pas edhe fizikisht e ka sulmuar duke kërkuar që ajo të largohet nga shtëpia. Atëherë ka ndërhyrë nëna pas çka djali me inicialet R.R ka sulmuar edhe nënën e tij duke e goditur me grushte në kokë dhe trup duke i shkakuar lëndime të dukshme trupore. Menjëherë R.R-ja e ka lëshuar shtëpinë, përderisa dy të sulmuarat S.R dhe F.S janë strehuar tek fqinjët e tyre. I denoncuar R.R dje është arrestuar dhe mbajtur në stacionin policor të Gostivarit për zbardhjen e plotë të rastit", informuan nga policia e Tetovës. Një nga zgjidhjet e mundshme për të siguruar strehim për viktimat nga dhuna në familje sidomos ndaj gjinisë femërore është që në kuadër të Spitaleve Klinike të hapen qendra për strehim.

Diaspora të identifikohet me shtetin, e jo me partitë

Shkup, 13 prill - Qeveria ka vendosur ta ngrrej në nivel më të lartë institucional, çështjen e diasporës dhe shteti të përkushtohet në ndërtimin e besimit me diasporën, theksoi në tribunën e djeshme, ministri pa portofol i obliguar për Diasporën, Edmond Ademi. "Dëshirojmë që diaspora të identifikohet me shtetin, e jo me partitë që ishte rast në 20 vitet e fundit... Kemi vënë re se në Maqedoni në vitet e fundit nuk ka ekzistuar strategji për bashkëpunim dhe marrëdhënie me diasporën, që nuk është rast me shtetet e rajonit dhe më gjerë. Prandaj nga fundit i muajit gusht të vitit 2017, Qeveria solli konkludim për formimin e grupit të punës i cili do të punojë në përpunimin e Strategjisë nacionale për bashkëpunim me diasporën", tha Ademi në tribunën për përforsimin e lidhjeve me diasporën e Maqedonisë. Ai informoi se Strategjia nacionale pothuajse është finalizuar dhe pritet gjatë qershorit të këtij viti ajo të hyjë në procedurën qeveritare. Strategjia nacionale bazohet në katër shtylla kyçe: politike dhe aspekte administrative, diaspora dhe zhvillimi ekonomik, arsimit, shkenca dhe rinia dhe lidhjet kulturore, identiteti kulturor dhe trashëgimia kulturore. Ademi përkujtoi se nga fundi i vitit 2017, Qeveria solli Program për rritje ekonomike të shtetit, ku përveç investimeve të huaja të cilat në të kaluarën kishin beneficione, tani edhe investuesit e vendit dhe investuesit nga diaspora i kanë të drejtat e njëjta kur do të vendosin të investojnë në Maqedoni. Ministri sqaroi se para dy javësh është sjell edhe Ligji për mbështetjen e investimeve, të propozuar nga Ministria e Ekonomisë. Me nenin 33 në ligj, investimet nga diaspora marrin mbështetje nga shteti. Ata do të marrin 10 për qind shitesë me qëllim që të tërhiqen për të investuar në shtetin e vet. Organizatori i tribunës, kryetari i Qendrës për mbështetje inovative dhe logjistike të qytetarëve "Kontakt i ri-Maqedoni" Zlatko Nikolovski tha se janë në dijeni se bashkatdhetarët tanë nuk do të mund t'i kthejmë mbrapa. Nga përvoja e tyre, bashkatdhetarët tanë më së shumti ankohen për informim dhe pyesin për lehtësimet administrative ndaj tyre. Sipas tij, shteti në periudhën e fundit ka bërë hap serioz. Në vitin 2011 për herë të parë diaspora ka marrë mundësi për të pasur deputetë, por ai mendon se ata kanë mundur të bëjnë diçka më shumë.

KRYETARI I KOMUNËS SË AKHISARIT VIZITOI KOMUNËN E GOSTIVARIT

Përvoja pozitive me Akhisarin

Gostivar, 13 prill - Kryetari i Komunës së Akhisarit të Republikës së Turqisë, Sali Hëzlë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi dje Komunën e Gostivarit ku u prit nga kryetari Arben Taravari dhe anëtarët e kabinetit të tij. "Në Komunën e Gostivarit, sipas regjistrimit të fundit, jetojnë mbi 82 mijë banorë, ku shumicën e popullsisë e përbëjnë shqiptarët, ndërsa pasojnë maqedonasit, turqit dhe romët. Bashkësitë etnike në Gostivar jetojnë në një harmoni të shkëlqyer, e sidomos shqiptarët dhe turqit, të cilët kryesisht njohin gjuhën e njëri-tjetrit dhe festat, dasmat dhe varrimet i bëjnë bashkë. Gostivari dhe Akhisari janë dy komuna të vëllazëruara dhe bashkëpunimin i cili daton prej shumë herët, me siguri se do ta thellojmë akoma më shumë dhe do ta shtrijmë në më shumë fusha", theksoi Taravari në takimimin në sallën e Këshillit të Komunës së Gostivarit, duke ftuar pjesëtarët e delegacionit që gjatë qëndrimit në Gostivar të

ndjehen si në qytetin e tyre. Siç thuhet në kumtesë, edhe kryetari i Komunës së Akhisarit bëri një prezantim të komunës me të cilën ai udhëheq tashmë tre mandate. "Komuna e Akhisarit ka rreth 170 mijë banorë dhe 109 vendbanime. Viteve të fundit kemi pasur një zhvillim të madh ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Por në Gostivar nuk vijmë që vetëm të përcjellim përvojat tona, por edhe të mësojmë nga përvojat tuaja. Kemi dëshirë që një delegacion i gjerë nga Komuna e Gostivarit të na vizitohet kështu siç ju vizitohet ne juve, ndërsa për këtë do t'ju bëjmë së shpejti edhe ftesë zyrtare", theksoi mes tjerash Hëzlë. Ndryshe, delegacioni i Komunës së Akhisarit përbëhej prej udhëheqësve të sektorëve pranë komunës dhe të disa këshilltarëve komunalë. Gjatë qëndrimit në Komunën e Gostivarit, u zhvillua një bashkëbisedim i gjerë me ç'rast të dyja palët u njoftuan më për së afërmi me sukseset dhe sfidat e komunave përkatëse,



si dhe u shkëmbyen përvoja pozitive. Kryetarët Taravari dhe Hëzlë shkëmbyen dhuratat të cilat simbolizojnë komunat të cilët ata i udhëheqin, ndërsa takimi përfundoi me një koktej rasti. Gjatë qëndrimit në Gostivar, delegacioni nga Akhisari do të vizitohet SHF "Mustafa K. Ataturk", Myftininë e Gostivarit dhe monumentet e trashëgimisë kulturore. (U.H)

MEMENTO MORI

Nga

Dr.Arben TARAVARI



Për njerëzit që janë mësuar të jetojnë nëpërmjet MASHTRIMIT e vetmja gjë më e rrezikshme se gënjeshtret është E VËRTETA!

Deri tash ne kemi jetuar nën Diktatin e Gënjeshtres. Nga sistemi i ngritur mbi MASHTRIMIN është ndërtuar kjo shoqëri tek e cila bëjmë pjesë dhe të cilën duhet t'a shpëtojmë! Mbi gënjeshtren janë hedhur themelet e këtij populli ku shumica jeton në varfëri, dhe pakica e pakicës në kushte ekstremisht të majme financiare.

Duket se biznesi më i mirë ka qenë dhe është aderimi në ndonjë parti dhe ardhja në pushtet.

Çuditërisht shumë pak janë ata njerëz të cilët janë futur të pasur në pushtet, por asnjë nuk ka dalë i varfër prej pushtetit. Kjo është dhe pika ku dua të ndaloj, tek dalja nga pushteti: sa raste kemi pasur ne të politikanëve të cilët kanë dalë nga pushteti dhe i është bërë analizë e pasurive që kanë dhe si i kanë vënë?!

Edhe Gruevskin (atë për të cilin Ali Ahmeti është shprehur se nuk mund të përflasë pasi kjo nuk i ka hijë një politikani), edhe ky njeri i cili në bazë të përgjimeve të nxjerra me aq bujë në atëbotë nga Zaevi, doli keqpërdorues i pushtetit, edhe ky njeri ende është vetëm i akuzuar, por ende jo i dënuar!

Këto politikan i përdorën këto përgjime si kuaj beteje për të shpëtuar Maqedoninë apo si mjet për të arritur qëllimet e tyre?

A është një gënjeshtër e radhës



nga politika, një goditje poshtë brezit apo është një histori që pret të na surprizojë për të mirë?

Se deri tash ne kemi jetuar me matricën "Qeveri Reformiste", mirëpo askund nuk ka ende aromë Reforme! Nuk po del asnjë xhakëtë e vjetër pushtetari para gjyqeve të premtuara, e më keq, gjysma e binomit, BDI-ja, të cilën Zaevi e shante, akuzonte, kërcënonte me Ditë Drejtësie, tragjikisht i rri në krah dhe udhëheq vendin!

Kur do dalin nga puna ata që e kanë bërë punën keq? Kur do fillojnë reformat?! Apo duhet të mirëkuptojmë arsyetimet infantile, fëmijërore të disa qeveritarëve se: për hir të stabilitetit të vendit duhet të bashkëpunojmë edhe me ata që janë për t'u nxjerrë nga pushteti!

Kur do mësojmë ne, kur do kuptojmë se edhe "qeveritarët" kanë një shef dhe ky shef është populli, dhe punëdhënësi të nxjerr nga puna kur

nuk e bën punën! Kur vjedh, punëdhënësi të çon në burg! E thjeshtë! Dhe këta mendojnë se me mashtrime e vendosin popullin në rrezik, por nuk kanë menduar për rrezikun që ju kanoset nga një armë tjetër, e pamenduar, që nuk e njohin, që është arma e popullit, arma e TË VËRTETËS! Mund ta gënjeshtrojmë një popull duke i marrë të drejtën për të qenë i lumtur, por nuk mund t'i shpëtosh TË VËRTETËS që ka rrezik të jashtëzakonshëm për qeveritarët tanë që nuk dinë të dalin nga puna!

Problemi qëndron në konceptimin e gabuar të personave që caktohen për të qenë në Qeveri!

Këta nuk e kuptojnë si vend pune, por si një tjetërsim të pozitës së tyre mbi tokë. Nga njerëz të zakonshëm transformohen në Perëndi dhe Qeveria në Malin e Shenjtë ku jetojnë këta mbinjerëzorët!

Këta zotërinj (me disa përjashti-

Problemi qëndron në konceptimin e gabuar të personave që caktohen për të qenë në Qeveri! Këta nuk e kuptojnë si vend pune, por si një tjetërsim të pozitës së tyre mbi tokë. Nga njerëz të zakonshëm transformohen në Perëndi dhe Qeveria në Malin e Shenjtë ku jetojnë këta mbinjerëzorët!



me), kur emërohen nuk mendojnë se futen në punë, por mendojnë se marrin pushtet dhe pretendojnë se duhet të rrinë aty përjetësisht.

Në zyrat e shtetit duhet të varet me çdo kusht një tabelë që shkruan "Memento Mori" që përkthehet "Kujtohu se do vdesësh"! Do i përgatiste për një marrëdhënie më të mirë me punën, me ndërgjegjen e tyre dhe padysim me Popullin! Ata kur janë në pushtet, janë të paprekshëm, por edhe pasi dalin nga pushteti - bëhet zhurmë nja disa ditë dhe pastaj... asgjë!

Pothuajse janë të amnistuar nga gjithçka! Ata që i zëvendësojnë nuk merren më me ta, a thua se i gjithë qëllimi është të lirojnë karriget e tyre e jo të japin llogari për gabimet e deri krimet e bëra!

A është Qeveria më e fortë se Populli?! A është e drejtë të jetë...?!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovassja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë 13 prill | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

MJEGULLNAJAT POLITIKE DHE MADHËSHTIA E TË VEGJËLVE



Nga Daut DAUTI

I shte "një javë e çmendur"! Javë e çmendur sportive, ndonëse deri diku ka qene edhe një javë traumatike politike. Më shumë në fqinjësi, se në Maqedoni.

Në Maqedoni, ndodhën gjëra që mëtuam ta turbullojnë sadopak ujin, për çka u përkujdes opozita. Lideri i ri i VMRO-DPMNE-së bëri "lëvizjen" e madhe në shahun politik, me epilogun e pritur të pat pozicionit. Ai, Mickovski, i cili vështirë e ka të ikë nga hija e mentorit të tij, pas bojkotit disa mujor, me t'u kthyer në parlament, u përpoq ta dridhë qeverinë! Ndoshta dikush ka besuar vërtet me fjalë të mëdha, të dëgjua e stërpërsëritura, do ta rrezojë. Ata të tjerët, që i bëjnë këto skenare politike nëpër PR-agjencitë, e dinë fare mirë lojën teatrore. E loja është të thuhet gjërat si të ishin para publikut teatrore për të marrë ndonjë duartrokitje për performancë dhe të vazhdojnë tutje, me një përshtypje artistike, por në të vërtetë, të pajtuar me fatin e një degradimi e strukcje në strofullën e tyre të qyqes. Se gjërat tash kanë marrë kahe tjetër nga duhet të shpëtohet çka mund të shpëtohet, se kur merr teposhtë, nuk di ku ndalesh. Nëse për një shfaqje plot teatralitet si ky mocioni për qeverinë "më të keqe deritash" (K. Mickovski) s'ke çka të shkruash më shumë veç se të konstatosh se e kemi kuptuar lojën, për ato gjërat tjera, për të cilat duhet shkruar, ende s'ka çka të thuhet konkretisht.

Me Greqinë jemi "kurrë më afër dhe ende larg" edhe pse rundi i radhës i takimeve të ministrave të jashtëm të të dy vendeve në Ohër (të enjten), pas asaj letre të Metju Nimicit palëve të ankoruara në pozicione të palëvizshme, duhej diçka t'i lëvizte gjërat nga vendi, sepse s'është mirë as për autoritetin e ndërmytesuesit të durueshëm dhe të stërpaguar nga OKB për t'i mbajtur në statuskuo rreth dy dekada e gjysmë. Diçka po ndodhë, ose më e madhja presim të ndodhë. Të paktën që atë emrin marroq pa përkthim dhe të pa ndarë GORNAMAKEDONIJA, ta heqin nga rendi i ditës si i palogjikshëm dhe i papranueshëm për "palën e tretë", atë që deri tash nuk ka bërë problem, sepse pas Sllavo-Maqedonisë, emri sllav pa përkthim, është edhe më i papranueshëm për shqiptarët. Një element plus është Memorandum i grupit të intelektualëve shqiptarë i cili sigurisht mund t'i japë shtysë subjektit shqiptar që të mos qën-



drojë parimisht pasiv për shkak të ndjeshmërisë identitare, të paktën të mos shkojë zgjidhja e kontestit nëpërmjet një emri të shtetit që do të ishte i papranueshëm për shqiptarët. Ndërkaq, nuk jam shumë i bindur se atributi gjeografik është i vetidentifikueshëm vetëm me maqedonasit, duke ditur historinë e vetë emrit Maqedoni, për të cilin historianët shqiptarë pajtohen se është më afër shqiptarëve se maqedonasve, prandaj nuk shoh ndonjë dramë që përcaktimi gjeografik, mund t'i përjashtojë shqiptarët nga identifikimi me të.

Në fillim është Zaevi edhe për çështjen e rikonstruimit të qeverisë, se ende nuk e ka të qartë cila Besë do të hyjë në qeveri, në të vërtetë, për ta pritur të kullohet uji cila është Besë e cila është Besa-Besë (nëse ma merr këtë emër ndonjë prej dy fraksioneve, do të kërkojë të drejtë autorësie për çka dëshmi e "patentimit" do të jetë ky shkrim!), se për Selën, tashmë dihet, vlen ajo popullorja "njër herë kalon miu nëpër mustaqe" (edhe pse në politikë asnjëherë nuk ka "kurrë më..."), ndërkaq për Thaçin, nuk e dimë ç'ndodh në prapaskenë, nëse më shumë seç ofron pozita e një subjekti të defaktori-zuar, ndonëse Zaevit, të gjithë i duhen vetëm si numra...

Nga skena politike shqiptare përtej kufijve, mund të thuhet se mjegullnajat vazhdojnë, duke mos ditur kur subjektet bëjnë diçka për shkak të interesit kombëtar që ata e marrin "në mbrojtje" me gojën plot patos, e kur gjithë këtë e bëjnë për interes politik të kalkular matematikisht. Por, gjithsesi, edhe ne që e shikojmë këtë prej anësh, nuk e kemi gjithnjë të lehtë për ta identifikuar se kur është e para, e kur është e dyta. Si në rastin e "taksës së Edi Ramës" në Rrugën e Kombit, ku debati u shtri nga Kukësi e gjer te ne me Pro e Contra qëndrimi, gjithnjë me kombin si argu-

ment. Opozita e Shqipërisë diti ta shfrytëzojë ose manipulojë revoltën e një pjese të banorëve të Kukësit pasi pothuajse si fluska sapuni u shfrynë argumentet se nuk duhet taksë rrugore për një autostradë normale si në gjithë Evropën. Dhe aty arritëm gjer në rebelimin që e thërriste Lul Basha por që me një dimension më të përparuar ose më inventiv se Vetëvendosja, e futi në Parlament. Gjersa Vetëvendosja në parlamentin e Kosovës vazhdimisht përdorte gaz lotsjellës, deputetët e PD-së këtë e bënë për taksën e Rrugës së Kombit me vezë (asgjë e re nga praktika, edhe bashkuesin e dy Gjermanive, Helmut Kollin e kishin gjuajtur me vezë), por dhe me një risi, që sigurisht edhe në botë do ta kopjojnë, duke hedhur miell ndaj kryeministrit Rama dhe ministrit të jashtëm, Bushati. Mielli zaten mund të ketë edhe ndonjëfarë simbolike, sepse ka vite që në Shqipëri gjithë politika është e mbar-sur me temën e trafikut të drogës, që te ne shpesh i themi "miell i bardhë", ndonëse kanabisi është bimë që pihet si duhan nga "konsumentët". Por, simbolika është aty.

Këtë kapitull të shkrimit, dua ta përfundoj me Kosovën, ku para dhjetë ditësh u trondit nga ekstradimi i gulenistëve, ish-partnerëve të koalicionit të Erdoganit dhe ajo që në këtë rast e bën të koklavitur, ku përzihen e drejta ndërkombëtare, procedurat (shumëkush thotë të shkelura) për rastet e këtilla e gjer, janë ndasitë dhe tifozllëku nga një numër jo i paktë shqiptarëve pro Haradinajt ose pro Erdoganit, një nonsens vetëdijësor për të na brengosur.

E lashë pra, me kaq, lexues të nderuar, ndoshta dhe e teprava që t'i përfshij në mënyrë telegrafike disa ngjarje (pasi nuk pata rast të shkruaj javën e kaluar për shkak se nuk doli numri i të shtunës) por

preferoj të merrem me gjëra më të bukura, siç është sporti. E sporti këtë javë na ofroi më shumë përjetime se çdo teatër politik, sepse na ofroi "tragjedinë" e të mëdhenjve nga të vegjlit. Rrjetet sociale pikojnë lot duke qarë fatin e Barcelonës së madhe (me dy futbollistët të super-klasit, si Mesi e Suarez) kundrejt Romës së vogël që shumë futbolldashës as nuk e dinë se kush janë lojtarët kryesorë të saj! E dërmoi dhe e turpëroi. Të njëjtin fat e përjetoi Manchester Siti, i cili me më shumë se gjysmë miliard investoi me transfere lojtarësh dhe me trajnerin momentalisht më kreativ në botë, Pep Guardiolen, me titullin tashmë të siguruar në Angli, u gjuhëzua nga një Liverpool që është i katërti në Premierligë. Për pak edhe Juventus-i do ta gjuhëzonte dhe pasi tashmë e kishte turpëruar me 3-0 Realin e Madridit mu në Madrid, por një gafë në mbrojtje dhe një vendim i diskutueshëm gjyqësor, vetëm disa sekonda para se të shkohej në vazhdime, nga privoi edhe nga një rënie e një titani. Shumë lot të tifozerive të tyre, sikur të ishte shembur toka! Futbollit ka një emër që ia kanë vënë ka herë "gjëja më e bukur e dorës së dytë". Ajo ka bukurinë e vet në "teknikën" e lojës, në lëvizjen me top, në vendosjen e futbollistëve, në dribling dhe në shutimin e topit. Shumëkush thotë se futbollit dikur ka qenë më i bukur, se sot mund të ketë më shumë teknikë, taktikë ose strategji, e cila bukurinë e vet e ka të fshehur, në qëllimin e fundit, të fitosh.

Po si gjithherë ka virtuoz të lojës që dallohen nga "orkestri" dhe ata janë ata që tërheqin publikun, që janë më të paguar, që tërheqin më shumë sponsorë e transmetime televizive për masovizim planetar.

Por, atyre që qanin për eliminimin e dy ekipeve kryesore pretendonte, duhet t'u themi se pikërisht aty qëndron bukuria, se nuk do të ishte interesante nëse të mëdhenjtë fitojnë gjithnjë, sepse do të humbte kuptimi i garimit. Bukuria qëndron në shansin që një Salzburg të eliminojë një ekip të madh gjerman dhe një ekip të madh italian, ose një Vardar që luan në një ligë si kjo e jona me pak publik, të gjejë motivin dhe ta gjuhëzojë një Fenerbahçe të një lige e cila tashmë u është afruar atyre evropiane për nga investimet dhe për nga popullariteti masovik. Pra, mos i qani të mëdhenjtë, se

Rrjetet sociale pikojnë lot duke qarë fatin e Barcelonës së madhe kundrejt Romës së vogël që shumë futbolldashës as nuk e dinë se kush janë lojtarët kryesorë të saj! Si Davidi që ia gjen pikën e dobët Goliatit, ose vëllai i Hektorit për të marrë hak, e godet gjysmëperëndi në Akilin në thembër, në të vetmen pikë të dobët. Pra, nuk ka të madh, pa ndonjë pikë të dobët, vetëmve nevojitet një strategji dhe motivacion që do të ngrejë moralin e skuadrës mbi mundësitë e tyre reale...



madhëstinë e tyre duhet ta tregojnë, e jo t'u dorëzohet dikush pa luftë. Sporti, sikundër edhe shumëçka tjetër, është një arenë e hapur dhe emocionet që na i ofroi futbollit këtë javë, bën që mos t'i përjashtojmë shanset e të vegjëlve. Si Davidi që ia gjen pikën e dobët Goliatit, ose vëllai i Hektorit për të marrë hak, e godet gjysmëperëndinë Akilin, në të vetmen pikë të dobët, thembër.

Pra, nuk ka të madh, pa ndonjë pikë të dobët, vetëmve nevojitet një strategji dhe motivacion që do të ngrejë moralin e skuadrës mbi mundësitë e tyre reale...

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

Ballkani, në të cilin ka filluar Lufta e Parë Botërore, është terren testues në Luftën e re të Ftohtë me Rusinë, përcjell "The New York Times" vlerësimet e analistëve. Ekspertët vlerësojnë se Rusia po e zgjeron ndikimin e vet dhe po shton tensionet etnike në vendet që shpresojnë të hyjnë në Bashkimin Europian për ç'shkak Brukseli ka rigjallëruar planet për zgjerim

Hulumtues në Institutin për marrëdhënie ndërkombëtare në Pragë Mark Galeotti ka vlerësuar se pas reagimit të përbashkët të Perëndimit për helmimin e spiunit të dyfishtë Sergej Skripal në Angli, "Ballkani po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm". "Rusia kërkon mënyra për t'i kthyer reagimet që do të ishin asimetrike e që do t'i siguronin rrethanat në Moskë", ka thënë Galeotti.

Ai në një artikull për European Council on Foreign Relations ka vlerësuar se "Rusia e vëzhgon Ballkanin si fushë beteje 'luftën politike' të saj në përpjekje që ta tërheqë vëmendjen për zhetonët për negociata me Bashkimin Europian".

Charles Kupchan, drejtor për Europën në Këshillin për Siguri Kombëtare në Shtëpinë e Bardhë gjatë kohës së Barack Obamas, ka thënë se "rusët shfrytëzojnë rrethanat në pjesën e fundit të Europës Perëndimore e cila edhe më tej është politikisht jofunksionale".

Situata në Ballkan deri diku ngjan në Ukrainë ku Rusia se pranoi që Kievi t'i afrohej BE-së por jo edhe NATO-s, por më pas e ndërroi

NEW YORK TIMES: BALLKANI, MUND TË JETË TESTI I RI I LUFTËS SË FTOHTË



qëndrimin gjë që solli në rrëzimin e regjimit prorus e më pas aneksimin e Krimesë.

Në Ballkan, gara me Rusinë ka potencial të shkaktojë destabilitet të ri në rajon i cili po vazhdon të shërohet nga luftërat e viteve të 90-a në të cilat u shkatërrua ish-Jugosllavia, thekson NYT.

BeH, e cila disi u bashkua në vitin 1995 në fund të luftës, edhe më tej është konstruksion i brishtë, e dërrmuar me korrupsion, udhëheqje të dobët, tensione etnike e nacionale, që është edhe metaforë e Ballkanit, thekson gazeta.

Kjo është njëra nga pikat kryesore të cilën Rusia përpiket ta shfrytëzojë, ka thënë Kupchan duke shtuar se të tjerat janë Maqedonia, Kosova dhe Serbia.

Bashkimi Europian ua ka ofruar shansin e ri për anëtarësim

vendete të Ballkanit Perëndimor, por askush nuk beson se këto vende janë të gatshme për hyrje në BE.

Gazeta thekson se pas daljes së Britanisë së Madhe nga BE dhe pas përpjekjeve të Rusisë që t'i shfrytëzojë plasaritjet në rajon, BE ka publikuar planin detajues për Ballkanin sipas të cilit Serbia dhe Mali i Zi mund të hyjnë në Bashkimin Europian deri në vitin 2025.

Ndërkohë për Ballkanin janë interesuar edhe amerikanët. Interesimi i ri i Washingtonit vjen nga shqetësimi për zgjerim të ndikimit rus, ka thënë Ross Johnson nga Qendra Wilson duke shtuar se Kongresi i SHBA-së kërkon nga Pentagoni të bëjë vlerësimin e bashkëpunimit të sigurisë të Ballkanit Perëndimor me Rusinë.

Galeotti vlerëson se Rusia për-

piqet ta gjejë vendin e vet edhe në qeveritë e kompanitë në Ballkanin Perëndimor ashtu që ato kur të futen në BE, ta shpien atje edhe ndikimin rus.

Ai vlerëson se BE nuk është e vëmendshme kur bëhet fjalë për Serbinë ku Rusia ka investimet kryesore në infrastrukturë e posaçërisht në energjetikë. "Politika e BE-së ka qenë të përkrahë çdo gjë që Ballkanin Perëndimor e mban në paqe. Kjo është shumë e rrezikshme dhe krijon mjedis të përkryer që Moska të luajë lojërat e veta", ka thënë Galeotti.

Ai, sikur dhe analistët tjerë, thotë se Brukseli duhet të ofrojë më shumë edhe kur bëhet fjalë për karotën e edhe kur bëhet fjalë për shkopin – ofrimin tërësisht për reformat institucionale dhe

shje të tyre.

Ish –zyrtari amerikan, i cili ka dashur të mbetet anonim, ka thënë se Ballkani është fushë e re beteje e Luftës së Ftohtë dhe ka shtuar se Brukseli ka qenë tepërmi rigid me mënyrat se si deshi ta mbante në rrugë të drejtë rajonin.

Ai ka thënë se reformat janë zbatuar vetëm kur Brukseli e Washingtoni i kanë detyruar liderët të heqin dorë nga shprehitë e vjetra me korrupsionin, kapjen e shtetit, gjyqësinë e politizuar dhe nga kompanitë ruse që përpiqen të kenë ndikimin kryesor në infrastrukturë dhe në medie.

Kupchan deri diku është optimist. Ai thotë se të gjithë e dinë se si do të përfundojë tregimi – me integrimin e të gjitha ish-republikave jugosllave në BE, por shtrihet pyetja se kur

Kosova e Serbia a mund të jenë si dy Gjermanitë në të kaluarën?

Sipas profesorit të Universitetit në Bukuresht, Franz-Lothar Altman, Gjermania nuk do ta kërkojë njohjen e Kosovës nga Serbia, por ai e përkujton modelin e dy Gjermanive

Ai ka thënë kështu në prag të takimit Merkel – Vuçiq.

Duke folur për kushtet e anëtarësimit të Serbisë në BE, Altman, ka thënë se kushtet që kanë të bëjnë me Kosovën, nuk ndryshojnë.

Altman, i cili është mik personal i Mekrelit ka shtuar se zgjidhja e çështjes së Kosovës është shumë e rëndësishme për Gjermaninë.

"Gjermania nuk do ta rati-fikojë anëtarësimin e Serbisë në BE nëse nuk ka zgjidhje të qartë e me marrëveshje për statusin e Kosovës", ka thënë Altman.

"Gjermania shqyrton anëtarësimin e mundshëm të Kosovës në BE që është e pamundur nëse Beogradi insiston se Kosova është

pjesë e Serbisë. Për dallim nga vendet tjera, Gjermania nuk insiston që Beogradi ta njohë Kosovën shtet të pavarur.

Por, ajo e përkujton situatën e ndërmjet dy Gjermanive gjatë Luftës së Ftohtë, kur u nënshkrua marrëveshje në vitin 1972, e cila Gjermanisë Lindore iu mundësua t'i hapeshin dyert për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare pa njohjen zyrtare të saj", ka thënë Altman.



“Homo antarcticus”, që në një pjesë të mirë përbën këtë libër, ishte nga më të vlerësuarit nga fondit për mbështetjen e procesit letrar nga Ministria e Kulturës. Ky libër është një përmbledhje në anglisht e dy librave të botuar në origjinal nga shtëpia botuese OMBRA CVC: “Pothuajse djë” (2012), dhe “Homo Antarcticus” (2015). “Homo Antarcticus” ose “Njeriu i Antarktidës”, nënkupton specien tonë të humbur, ato tipare që civilizimi i ka rrafshuar te njeriu. Frank Wild, i cili është një nga heronjtë realë që i mbijetoi kushteve ekstreme të Antarktidës për dy vjet, më pas nuk arriti t’i mbijetonte qytetërimit, normalitetit. Kjo histori e cila është pak a shumë historia e shumë zbuluesve, më ngacmoi një pyetje të vjetër që më mundonte prej kohësh: cili është heroi i vërtetë, ai që arrin të ndeshet me të pamundurën dhe të ia dalë, apo ai, njeriu i rëndomtë, “antiheroi”, i cili duhet të punojë përditë për të siguruar bukën e gojës, për të paguar qiranë, shkollën e fëmijëve, kredinë e bankës, me ankthin e përjetshëm për t’u ndjerë i pranuar në shoqëri. Por si çdo poemë e gjatë, ajo prek edhe çështje të tjera, si: shoqërinë e konsumit, rolin e individit, personazhet në hije, absurditetin e luftërave, egon kolektive etj.”, është shprehur Lleshanaku për “Homo Antarcticus” në një intervistë për gazetën Mapo. Përkthyesja e librit në anglisht është Ani Gjika, e cila, për përkthimin e këtij libri, së fundmi është vlerësuar me çmimin e PEN-it anglez dhe me një grant nga National Endowment for Arts në Shtetet e Bashkuara. Ndërkohë “Hapësira negative” është njëri nga librat e rekomanduar nga Poetry Society në Angli.

Ja se si shprehet në komentimin e tij, poeti dhe përkthyesi George Szirtes: “Hapësira negative e poetes shqiptare Luljeta Lleshanaku është li-

SUKSESI I LULJETA LLESHANAKUT ME LIBRIN ‘HAPËSIRA NEGATIVE’

MES 7 TITUJVE MË TË MIRË QË BOTOHEN KËTË MUAJ NË AMERIKË

Kam lindur një të martë prilli/ Nuk qava. Jo se isha e habitur, por as e inatosur/Isha vezorja me fat. E trajnuar për mirënjohje/nëntë muaj rresht në bark...Këto vargje që të çojnë në vëllimin poetik “Hapësirën negative” të Luljeta Lleshanaku lajmërojnë njëkohësisht në këtë fillimprill se ky libër sapo ka kaluar në kontinentin tjetër, atë amerikan. Libri është renditur mes 7 librave më të mirë që botohen në këtë muaj në Amerikë

bri i saj i dytë i botuar në Mbretërinë e Bashkuar, megjithëse Neë Directions në Shtetet e Bashkuara, e ka botuar që në vitin 2002. E lindur në vitin 1968 dhe e vlerësuar si një poetë kryesuese e brezit të saj, Lleshanaku është përkthyer fuqishëm nga Ani Gjika. Libri fillon me një poemë të gjatë që i referohet zbuluesit të Antarktidës Frenk Uajld, krahu të djathtë të Shakëlltonit. Kjo poemë është plot forcë, dhe ofron një revokim të kursyer por të gjallë, pothuajse filmik, të jetës së Uildit, që mund të shërbejë si një lloj analogjie e vetë jetës së autores. Prej këtu, autorja lëviz nëpër një varg karakteresh dramatike, para se të rikthehet përsëri në vetën e parë.

Syri i saj është kureshtar; shqisa e saj për të ndërtuar detajin, herë pas here të mahnit. Dhe çështje më e rëndësishmja, ajo i paraqet lexuesit një version të besueshëm të botës...Kështu që janë thjesht gjërat në vetvete, ai grumbull mbresëlënës copërash, fragmentesh, ku lënda përzihet me idetë në mënyrën më të natyrshme të mundshme, me një shkathtësi numrash akrobatikë. Ajo nuk bën asgjë ekstravagante në aspektin teknik ose atë retorik. Ajo flet drejtpërdrejt: por vetëm se ky i folur direkt është i mprehtë (ashtu siç është edhe përkthimi) dhe e vë gishtin drejt e në plagë”. Ndërsa në prezantimin që botuesi i bën auto-

res në kopertinë, ndër të tjera thuhet: “Shumë nga poezitë nuk i referohen ndonjë vendi specifik ose kohe specifike. Ngjarjet intervenciojnë midis tyre dhe ngjarje të reja marrin formë, ashtu si në poemën e saj të gjatë “Homo Antarcticus”, e cila ndjek fatin e një heroi, i cili, ndërsa ia doli të përshtatej për muaj me radhë me vdekjen nga uria në Antarktidën e ftohtë nën zero gradë, nuk mundi të përshtatej më pas me jetën në qytetërim. Kjo është njëra nga poemat në libër që flet për presionin e shoqërisë moderne mbi individin. Brenga dhe vdekja, dashuria dhe dëshira, burgosjet dhe zhgënjimi, janë të gjitha tema që bëjnë jehonë në poezinë

magjepsëse të Lleshanakut”.

Në gjuhë të tjera: “Hapësira negative” është libri i dhjetë i autores, botuar në gjuhë të tjera, pas: Hayëire; Neë& Selected Poems (Bloodaxe Books, Londër, 2011), Fresco (Neë Directions, SHBA, 2002), Child of nature (Neë Directions, SHBA, 2010), Kinder der Natur (Edition Korrespondenzen, Austri, 2010), Dzieci natury (Stoëo / Terytoria Obraz, Poloni, 2011), Antipastorale (Lieto Colle, Itali 2006), Ponedjeljak u sedam dana (Versopolis edicija, Kroaci, 2015), Lunes en Siete Días (Olifante, Spanjë, 2017) dhe Pondelok v siedmich dňoch (Občianske združenie VLNA, Sllovakia, 2017).

Origjinën e fustanellës helene kërkojeni në Shqipëri

Në revistën franceze, ‘L’Année géographique: revue annuelle des voyages de terre et de mer ainsi que des explorations, missions, relations et publications diverses relatives aux sciences géographiques et ethnographiques’, botuar në 1872 nga shtëpia botuese « L. Hachette et Cie (Paris) » gjejmë, në faqen n°327, shkrimin e arkeologut të njohur francez, Albert Dumont, i cili gjendej në Shqipëri gjatë verës po të atij viti. Si përshkruhen shqiptarët në këtë shkrim? Në vijim do të gjeni rrëfimet brilante, të revistës dhe të autorit, mbi popullin tonë, të sjella në shqip nga Aurenc Bebjë, Blogu « Dars (Klos), Mat – Albania »:

Rrëfimi i revistës mbi shqiptarët nëpërmjet udhëtimit të arkeologut francez në Shqipëri:

“Shqipëria, ku në të cilën Z. Albert Dumont ka hyrë nëpërmjet Shkodrës, e vendos atë në qendër të vëzhgimeve të reja. Në Dalmaci, autori studion kryesisht vendin, ndërsa në Shqipëri popullin. Shqiptari—



«Skypëtar» siç i quan ai vetë—është një popull i virgjër, pothuajse primitiv, i cili nuk ka ngjashmëri me evropianin (me perëndimorin). I familjarizuar me antikitetin helenik, Z. Dumont, është habitur çdo moment nga kostumi, zakonet, traditat apo analogjitë shqiptare, të cilat i kujtojnë atij Grekët e kohëve Homerike. Shqiptarët banojnë në trojet që dikur ishin të Pellazgëve.

Ka shumë mundësi që një pjesë e gjakut të këtyre banorëve të lashtë (e kësaj rrace parësore) rrjedh ende në damarët e shqiptarëve.”

Rrëfimi i arkeologut francez për shqiptarët:

“Shqiptari dallohet përsosmërisht; koka e tij e vogël, hunda e hollë, syri i mprehtë, i çelur si bajame, qafa e gjatë, trupi i dobët, këmbët e gjata dhe të forta, ai na kujton

Grekët e lashtë, ashtu siç e gjejmë në skulpturën arkaike prej mermëri të Eginës. Edhe kostumi (veshja) i tij vë në pah kujtimet e antikitetit. Fustanella e bardhë na kujton tunikën me pala deri në rrip, ndërsa gjunjakët (tirqit) e gjatë që mbështjellin këmbët deri në gjunjë janë mbrojtësit e kërcinjëve të epokës heroike. Kostumi nuk është i gjerë dhe i fryrë si në epokën e

bukur greke; por dallojmë, në vazot e stilit të vjetër që, (Në 1870, Ministria franceze e Arsimit publik i ka dhënë për mision autorit të studiojë vazot e pikturuara greke dhe të zbulojë prejardhjen e tyre), Helenët e dikurshëm nuk kanë pasur zakonet e bashkëkohorëve të Periklit. Pikërisht, shpjegimi i kostumeve më të vjetra helenike duhet kërkuar në Shqipëri.”

L’Albanie, où M. Albert Dumont entre par Scutari, le place au milieu d’un nouveau champ d’observations. En Dalmatie, c’est le pays surtout qu’il étudie; en Albanie, c’est le peuple. L’Albanais, — le Skypëtar, comme il se nomme lui-même, — est un peuple vierge, presque un peuple primitif, qui n’a rien d’Européen. Familier avec l’antiquité hellénique, M. Dumont est à chaque instant frappé, dans le costume, dans les mœurs, dans les habitudes, d’analogies qui lui rappellent les Grecs des temps homériques. Les Skypëtar occupent, du reste, ce qui fut autrefois la terre des Pélasges, et il y a grande apparence qu’une partie au moins du sang de la race primordiale coule encore dans leurs veines.

Ekspertë të shoqërisë civile, institute e analistë si nga Kosova edhe nga Serbia janë mbledhur nga fondacioni gjerman Friedrich-Ebert për të skicuar skenarë të mundshëm të zhvillimeve të konfliktit deri në vitin 2035

THAÇI E VUÇIQ KRIJOJNË NJË KONFLIKT NË MËNGJES QË TË MUND TA ZGJIDHIN PASDITE



Gati një dekadë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, shtatë vite pas fillimit të dialogut me ndërmjetësimin e BE-së dhe pesë vjet nga marrëveshja e Brukselit që synonte hapjen e një kapitulli të ri në marrëdhëniet Kosovë-Serbi, konflikti mbetet ende i ngrirë. Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, megjithëse një shumicë e vendeve të OKB-së e kanë njohur shtetin e ri, Rusia që qëndron në krah të Serbisë çdo kohë mund të bllokojë me veto në Këshillin e Sigurimit, anëtarësimin e Kosovës në OKB.

KATËR SKENARË – SI DO TË JENË ZHVILIME DERI NË VITIN 2035?

Dialogu i filluar në Bruksel ka eliminuar disa probleme që rëndojnë jetën e përditshme të njerëzve dhe i ka shpërbërë në një masë të caktuar strukturat serbe në veri të Kosovës si gjykatat dhe policinë. Por pengesa kryesore mbetet diferenca e pakapërcyeshme për statusin e territorit me 2 milionë banorë, më së shumti shqiptarë. Faktori ndërkombëtar ka rritur presionin ndaj Prishtinës dhe Beogradit për të përcaktuar marrëdhëniet e tyre në një marrëveshje të gjerë të normalizimit.

Grupe përfaqësuese nga shoqëria civile, institute dhe bota akademike si nga Kosova, Serbia bashkë me ekspertë të BE janë mbledhur

nga fondacioni gjerman, Friedrich Ebert-Stiftung për të skicuar katër skenarë të mundshëm të zhvillimit të marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë deri në vitin 2035. Ata do të prezantohen të premten (13.04) në Beograd, por Deutsche Welle sjell ekskluzivisht disa pjesë të këtij dokumenti.

RRUGA MË E SHPEJTË DREJT PROGRESIT

“Skenari më i mirë do të ishte ai që zgjidh përfundimisht grindjen për statusin”, thotë njëri nga pjesëmarrësit në këtë projekt të fondacionit gjerman, Shpëtim Gashi nga Instituti “Council for Inclusive Governance”. Skenari i “dallgës së gjelbër” nënkupton arritjen e një marrëveshje të gjerë normalizimi mes Serbisë dhe Kosovës në vitin 2019. Kështu Serbia bëhet anëtare e BE në vitin 2025, Kosova merr liberalizimin e vizave në vitin 2019, bëhet anëtare e të gjitha organizatave ndërkombëtare dhe pret t’i bashkohet BE në vitin 2037, dhe Serbia

e mbështet anëtarësimin e saj.

Sipas këtij skenari si Kosova edhe Serbia kanë përmirësime ekonomike. “Por për të arritur deri këtu, Kosova dhe Serbia duhet të marrin disa vendime kyçe. Beogradi duhet të heqë dorë nga pretendimi territorial mbi Kosovën, dhe Kosova të themelojë Asociacionin e Komunave Serbe me disa fuqi ekzekutive. Një paketë impulsesh financiare dhe politike janë të nevojshme për të inkurajuar këtë proces”, thotë eksperti Shpëtim Gashi për Deutsche Welle.

Sipas Gashit, më i mundshëm është një kombinim i skenarëve të dytë dhe të tretë. Këta skenarë nënkuptojnë nënshkrime marrëveshesh, por që nuk implementohen. Në marrëveshje njihet nga Beogradi autoriteti i Prishtinës në të gjithë territorin e Kosovës, por pa njohje të plotë diplomatike të Kosovës. Në të njëjtën kohë, Beogradi vazhdon të llobojë kundër anëtarësimin të Kosovës në organizmat ndërkombëtarë.

ISH-ARMIQTË NË PUSHTET

Arsyeja, se pse ky kombinim mund të jetë edhe skenari më i mundshëm është sepse lidhshipi si në Kosovë edhe në Serbi nuk ka vullnetin të heqë dorë nga retorika populiste. Aktualisht të dyja vendet drejtohen nga armiqtë e dikurshëm. Aleksander Vuçiq ka qenë ministër i Informacionit në kohën e luftës së Kosovës, ndërsa presidenti Hashim Thaçi ishte një nga drejtuesit e UÇK-së. “Vuçiq dhe Thaçi janë përpjekur shumë të prezantojnë veten si paqebërës, që në të vërtetë nuk janë. Ata më shumë janë përpjekur që në t’u besojmë. Por ata janë produkt i konfliktit dhe mbeten në pushtet për shkak të konfliktit. Ata krijojnë një konflikt në mëngjes që të mund ta zgjidhin atë pasdite”, thotë eksperti Shpëtim Gashi. Sipas tij, kërkohen hapa të guximshëm për të zgjidhur konfliktin, por mungon lidhshipi për këtë. Lidhshipi ynë nuk ka integritet, ka një të kaluar të përzier dhe nuk është i gatshëm për të lënë pas një trashëgimi të vjetër, thotë Gashi për DE.

BAST PËR DËSHTIMIN

Me politikanë të tillë mund të vësh bast për dështimin, kritikon Gashi. Rezultati i dështimit do të bëjë që, megjithë disa përpjekje, ekonomitë e dy vendeve të përkeqësohen. “Konflikti është një faktor jo i vogël që kontribuon në problemet ekonomike, por kam frikë se si Kosova edhe Serbia kanë shkuar shumë larg për t’u kthyer pas. Kosova gjithnjë e më shumë po bëhet një shoqëri konsumi, që importon 90% të të ardhurave, dhe eksporton vetëm 10%, ndërsa Serbia me më pak se 2% rritje ekonomike renditet në 10 vendet me ekonominë globale më të dobët”, thotë Shpëtim Gashi.

Në këtë analizë të ekspertëve e instituteve të studimit, skenari më i keq do të ishte shpërbërja e BE-dhe kalimi i tij në një aleancë të lirshme ekonomike, duke bërë që të ngrijë procesin e zgjerimit me vende të Ballkanit Perëndimor. Në këtë rast BE humb levën ndikuese në Prishtinë dhe Beograd. Me humbjen e perspektivë së anëtarësimin, si Prishtina dhe Beogradi humbasin interesin për negociim dhe vazhdojnë të fajësojnë njëra-tjetrën. Në rast të tillë nuk ka më një oponencë të fortë ndaj ligjërimit nacionalist, kjo do të çonte në rritjen e tensioneve në shumë zona ku banojnë serbë në Kosovë, sidomos në veriun e saj, theksohet në skenarin më të keq për zhvillimet deri në vitin 2035. Me tensione të larta e zëra të dobët që kërkojnë një zgjidhje “një luftë e re do të ishte vetëm një shkëndijë larg”.

ORA BOTËRORE E VARFËRISË

NË SHQIPËRI NËN 3% E POPULLATËS NË VARFËRI EKSTREME

Ora Botërore e Varfërisë mundëson një përllogaritje në kohë reale deri në 2030 për të gjithë shtetet botërore, si dhe monitoron progresin si pjesë e programit kundër varfërisë ekstreme. Ky është një nga objektivat e mijëvjeçarit (SDG) të OKB, për zhvillimin e qëndrueshëm të shteteve.

Sipas website kryesor, në botë norma e largimit nga varfëria aktualisht është 1.1 njerëz në sekondë, sakaq objektivi i OKB është 1.5 njerëz për sekondë.


Sipas hartës, në prill 2018, Shqipëria nuk ka varfëri ekstreme. Ndërkaq sipas përllogaritjeve, 0.4% e popullsisë (2.92 mln njerëz përafërsisht) jetojnë në kushte varfërie ekstreme, ose sipas grupimeve të përcaktuara, bëhet fjalë për nën 3% të popullatës. Në rajon, Maqedonia dhe Rumania janë ende nën monitorim të arritjes së objektivave të SDG për zhdukjen e varfërisë në 2030, ndërsa asnjë sh-

tet nuk rezulton me varfëri ekstreme në rritje.

Raporti shkruan se, edhe pse shkalla e varfërisë globale është përgjysmuar që nga viti 2000, kërkohet përpjekje të intensifikuar për të rritur të ardhurat, për të lehtësuar vuajtjet dhe për të ndër-tuar elasticitetin e atyre individëve që ende jetojnë në varfëri të skajshme, veçanërisht në Afrikën Sub-sahariane. Sistemet e mbrojtjes sociale duhet të zgjerohen dhe rreziqet duhet të zbuten për vendet e prirura nga fatkeqësitë, të cilat gjithashtu kanë tendencë të jenë shtetet më të varfëra, tramseton

revista MONITOR.

Sistemet e mbrojtjes sociale janë themelore për parandalimin dhe reduktimin e varfërisë dhe pabarazisë në çdo fazë të jetës së njerëzve, nëpërmjet përfitimeve për fëmijët, nënat me të porsalindurit, personat me aftësi të kufizuara, personat e moshuar dhe personat që janë të varfër dhe pa punë. Të dhënat paraprake tregojnë se në vitin 2016, vetëm 45 për qind e popullsisë së botës u mbrojt në mënyrë efektive nga një sistem i mbrojtjes sociale dhe se mbulimi ndryshonte gjerësisht nëpër vende dhe rajone.



Ndërtimi i një sistemi të domosdoshëm për të mbrojtur të varfrit dhe forcimi i reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë është një strategji thelbësore e zhvillimit për t’i dhënë fund varfërisë së skajshme në vendet më të goditura.

Humbjet ekonomike nga fatkeqësitë tani arrijnë një mesatare prej 250 miliardë deri në 300 miliardë dollarë në vit. Rreziku i katastrofës në nivel global është shumë i përqendruar në vendet me të ardhura të ulëta.

Shtetet e Bashkuara dhe Rusia mund të gjejnë një mënyrë për të folur me njëri-tjetrin, beson zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme të Rusisë, Maria Zakharova ndërkaq sipas shefit të Pentagonit, James Mattis, SHBA, mbetet e përkushtuar ndaj negociatave të mbështetura nga OKB-ja në Gjenevë për t'i dhënë fund luftës

Për dallim nga Presidenti i SHBA-së Donald Trump që kërkon në mënyrë të menjëhshme të bombardojë artillerinë ushtarake të regjimit Assad, shefi i mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara James Mattis ka kërkuar kujdes në lidhje me këtë çështje. Në një dëgjim në publik të enjten, Mattis deklaroi para anëtarëve të kongresit se Shtetet e Bashkuara nuk do të "angazhohen në një luftë civile", dhe mbetet e përkushtuar ndaj negociatave të mbështetura nga OKB-ja në Gjenevë për t'i dhënë fund luftës.

"Ne jemi duke provuar për t'i dhënë fund vdekjeve të civilëve të pafajshëm. Në një nivel strategjik është si e mbajmë këtë larg një përshkallëzimi," tha ai, raporton "Al Jazeera".

"Strategjia jonë mbetet e njejtë

KOMPROMISE RRETH SULMEVE MBI SIRINË



sikur para një viti: Për ta çuar këtë në një paqe të ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara. Në të njëjtën kohë, ne e mbajmë këmbën tonë në qafën e ISIS-it derisa ta mbytim atë," tha ai duke iu referuar Shtetit Islamik të Irakut dhe Levantit e njohur edhe si ISIS. Gjithashtu ai tha se nuk ka kurrfarë arsye që Uashingtoni dhe Moska të luftojnë me njëra tjetrën, duke shtuar se "ne kemi nevojë që të gjitha kombet të punojnë së bashku". Megjithatë, Shtetet e Bashkuara dhe Rusia mund të gjejnë një

mënyrë për të folur me njëri-tjetrin, beson zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme të Rusisë, Maria Zakharova. Ajo tha se Uashingtoni mund të sulmojë, por Moska do t'i qëndrojë afër popullit të saj. Zakharova paralajmëroi se Uashingtoni dhe Moska nuk duhet që tensionet mbi Sirinë t'i përshkallëzojnë në terren, raporton "RT".

E pyetur rreth një skenari të mundshëm të një lufte mes Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara, Zakharova tha se dyja shtetet kanë të gjitha mjetet për të parandaluar

një përballje të tillë me pasojat potencialisht shkatërruese. "Ne jemi duke jetuar në vitin 2018 dhe kemi të gjitha llojet e komunikimit, përfshirë Twitterin, ku ne mund t'i përgjigjemi gjitha pyetjeve si komunikimit me telefon, dërgimit të mesazheve – dhe mendoj se ky është rasti i cili duhet të zgjidhet përmes komunikimit, por jo përmes forcës", tha zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme. Zakharova përsëriti se Rusia do të mbrojë popullin e saj nëse raketat fillojnë të fluturojnë drejt qiellit rus.



Pse u mbyll një gazetë konservatore në Hungari?

Lajmi plasi në redaksi "si një sulm terrorist me bombë", kështu i përshkruan që të paktën punonjësit e "Magyar Nemzet" ndjenjat e tyre kur lexuan se gazeta e tyre do të mbyllet. Kjo gazetë konservatore ka traditë të gjatë dhe është themeluar në vitin 1938. Në faqen e parë të numrit të fundit të gazetës që shtypur një shirit i ri me mbishkrimin "1938 – 2018". Në një deklaratë redaktorët shkruajnë: "Ne besojmë se demokracia dhe informimi i paanshëm i publikut në Hungari do të vazhdojnë të ekzistojnë dhe shprejsojmë të rikthehemi!", shkruan DW. Mbyllja e gazetës pas fitores së fundit në zgjedhjet e së dielës të Viktor Orbánit ka një histori të komplikuar. Gazeta "Magyar Nemzet" "Kombi Hungarez", ishte pas përfundimit të diktaturës komuniste media kryesore nacional-konservatore. Në vitin 2000 gazeta u bashkua në mënyrë jo të qartë me një gazetë tjetër të djathtë dhe kaloi nën kontrollin e oligarkut hungarez Lajos Simicska. Ai është një mik i vjetër dhe shoku shkollë i Viktor Orbánit, dhe për dy vjet e gjysmë ka qenë një emincencë enigmatike gri brenda partisë së Orbánit Fidesz.

Me perandorinë e tij të biznesit "Kézzép" në të cilën ndër të tjera bëjnë pjesë firma ndërtimi dhe kompani mediatike, ai organizonte në prapavijë financat e partisë Fidesz dhe i siguroi asaj pavarësinë ekonomike me anë marrëveshjes të dyshimta. Simicska i qëndroi besnik Orbánit edhe pas disfatës në vitin 2002 dhe ngriti një sipërmarrje të fuqishme mediatike besnike të partisë Fidesz, sepse Orbán mendonte se i kishte humbur zgjedhjet për shkak të njoftimeve në mediat armiqësore hungareze.

Pas fitores së Orbánit në vitin 2010 firmat e Simicskas fituan shumë tendera publike dhe oligarku u bë një ndër njerëzit më të fuqishëm të Hungarisë. Kjo zgjoi dyshime te Orbánit që e konsideron atë si tepër të fuqishëm. Në vitin 2015 shokët e dikurshëm u prishën, sepse Simicska donte që të bashkëqeveriste jozyrtarisht.

MBI 1000 FËMIJË TË RRËMBYER NGA BOKO HARAM

UNICEF tha se militantët kanë rritur sulmet ndaj fëmijëve me efekte shkatërruese mbi edukimin dhe të ardhmen e tyre

Militantët e organizatës terroriste Boko Haram kanë vazhduar shënjestrimin e fëmijëve në fushatën e dhunës që ka përfshirë mbi një mijë fëmijë të rrëmbyer dhe miliona të tjerë të shpërngulur në verilindje të Nigerisë. Në një deklaratë një ditë para përvjetorit të katërt të rrëmbimit të 276 nxënësve nga qyteti Chibok, UNICEF tha se militantët kanë rritur sulmet ndaj fëmijëve me efekte shkatërruese mbi edukimin dhe të ardhmen e tyre. Së paku 112 vajza mbetën në robërinë e organizatës Boko Haram. Më 19 shkurt, militantët përsëri organizuan një rrëmbim masiv të rreth 112 vajzave dhe një djali në qytetin verilindor Dapchi në shtetin Yobe. "Katër vjetori i rrëmbimit në qytetin Chibok na kujton se fëmijët në Nigerinë



verilindore vazhdojnë të sulmohen në një shkallë tronditëse", thuhet në deklaratën e përfaqësuesit të UNICEF-it në Nigeri, Mohamed Malick Fall. Fall shton se ata janë shënjestër e vazhdueshme dhe të ekspozuar ndaj dhunës brutale në shtëpi, shkolla dhe vende publike. Agjencia tha se sulmi i fundit në një shkollë në Dapchi, në të cilën pesë prej vajzave humbën jetën, ishte tregues se ka pak hapësira të sigurta për fëmijët në verilindje. "Këto sulme të përsëritura kundër fëmijëve në shkolla janë të paarsyeshme. Fëmijët kanë të drejtën e arsimit dhe të mbrojtjes dhe klasa duhet të jetë një vend ku ata janë

të sigurt nga dëmtimi", tha Fall. Gjatë ditës së nesërme, lëvizja #BringBackOurGirls (Sillni vajzat tona) do të mbajë një ligjëratë mbi përvjetorin e katërt në kryeqytetin Abuja. Ligjëratat titullohet "Drejt një shoqërie të drejtë dhe të mirë: Përtëritja e përkushtimit tonë ndaj fëmijës vajzë në Nigeri". Që nga konflikti që nisi në Nigerinë verilindore, pothuajse nëntë vite më parë, të paktën 2.295 mësuës janë vranë dhe më shumë se 1.400 shkolla janë shkatërruar. Shumica e këtyre shkollave nuk janë rihapur për shkak të dëmtimit të madh apo pasigurisë në vazhdimësi.



Në Turqi arrestohen edhe 70 oficerë

Prokurorët turq kanë urdhëruar arrestimin e 70 oficerëve të ushtarisë, të cilët dyshohet se kanë lidhje me klerikun Fethullah Gulen, të cilin Ankara e akuzon se qëndron prapa tentim grusht-shtetit më 2016. Policia turke ka kryer operacione në 34 provinca në mbarë vendin, ka raportuar e përditshmja turke Milliyet, përcjell Reuters. Thuhet se të dyshuarit janë vënë në shënjestër pas deklaratave të ushtarëve që janë arrestuar më parë. Zyrtarët ushtarakë të arrestuar në operacionet e fundit, thuhet se bëjnë pjesë në lëvizjen Hizmet (Shërbim) të Gulenit. Zyra për të drejtat e njeriut e OKB-së ka thënë se autoritetet turke kanë arrestuar 160 mijë njerëz dhe kanë larguar nga puna pothuajse të njëjtin numër të nënpunësve civilë, pas çuqit të dështuar të korrikut të vitit 2016.

TREVAT VERILINDORE SHQIPTARE DHE REZISTENCA ANTIKOMUNISTE 1945-1948 (4)

KUSHTETUTA E 1946-ës QË ELIMINOI SHQIPTARËT



Nga Qerim LITA

(vijon nga numri i kaluar)

Ndërhyrja në planprogramet mësimore për shkollat shqipe, erdhi menjëherë pas zbulimit të organizatës Nacional Demokratike Shqiptare dhe burgosjes së një numri të madh të mësuesve shqiptar, nën pretekst se të njëjtit ishin anëtar të kësaj organizate. Mësuesit shqiptarë në atë periudhë kohore përbënin klasën "më të rrezikshme" për pushtetin e atëhershëm të RP të Maqedonisë. Në analizën e hartuar në shkurt të vitit 1952 nga Komisioni i Byrosë Politike të PKM-së, me Kërste Cërvenkovskin në krye, vihej në pah se "reaksionin shqiptaromadhi e mbajnë gjallë mësuesit shqiptarë", të cilët, analiza i ndante në tre grupe: "grup mësuesish që kanë ardhur nga Shqipëria që nga koha e okupacionit (këta janë me përgatitje më të lartë arsimore, mirëpo të edukuar me ide të ndryshme shoviniste); grup mësuesish që kanë ardhur nga Shqipëria pas Luftës së Dytë Botërore (edhe këta pjesërisht janë me arsim të lartë, mirëpo të edukuar me ide për bashkimin e Shqipërisë), dhe grup mësuesish i cili numerikisht është më i madh (të krijuar në territorin tonë nëpërmjet kurseve, ndërsa ata kryesisht janë fëmijë të ish bejlerëve, ulemave dhe zejtarëve të ndryshëm dhe gjimnazistë të papërfunduar). Edhe këta janë kuadër të krijuar nga dy grupet e para..."

Ngjashëm si Cërvenkovski, shpreheshin edhe organet e UDB-së. Në raportin që ky shërbim në vitin 1953 ia dërgoi Byrosë Politike të PKM-së, veç tjerash thuhej: "Inteligjenca e cila erdhi gjatë kohës së okupacionit dhe ajo që erdhi pas çlirimit, ishte drejtuesja e më shumë ngjarjeve irredentiste dhe shoviniste. Nga këto mësues u krijua organizata Nacional Demokratike Shqiptare. Mendimet e veta shoviniste dhe irredentiste mësuesit i përcjellin sistematikisht dhe me shkathësi të shtresat. Vetë detyra e NDSH-ë ishte: restaurimi i së vjetrës me ndihmën e perëndimit për krijimin e Shqipërisë së Madhe..."

Kulminacionin e antishqiptarizmit, udhëheqja komuniste maqedonase e arriti me Kushtetutën e parë, e cila u miratua më 31 dhjetor 1946, ku shqiptarët përfundimisht u emërtuan si pakicë nacionale, duke u përfshirë vetëm në një pikë të saj, përkatësisht në Kreun III neni 12 në të cilin shprehimisht thuhej: "Pakicat nacionale në Republikën Popullore të Maqedonisë gëzojnë të



Regjimi komunist jugosllav, përkatësisht ai maqedonas, krahas mësuesve dhe veprimtarëve të Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, si armiq të tyre i konsideronte edhe ulematë shqiptarë, veçmas mbështetësit e politikës së Atullah Efendiut, përkatësisht pasardhësit e tij siç ishin: Fetah Efendiu, Mehmet Efendiu, Xhemal Efendiu, Ferat Efendiu e shumë të tjerë, të cilët deri në vdekje qëndruan besnik ndaj idealeve të tyre fetare e kombëtare

drejtën e mbrojtjes dhe zhvillimit kulturor dhe në përdorimin e lirë të gjuhës së tyre".

Viti 1947 filloi me një fushatë të egër anti-shqiptare nga ana e udhëheqjes komuniste maqedonase, e cila u karakterizua me procese të shumta gjyqësore kundër veprimtarëve kombëtar e fetar shqiptar. Nga data 26 janar e deri më 7 shkurt të vitit 1947, në Shkup u mbajt procesi gjyqësor kundër kreut më të lartë të KQ të NDSH-së, me ç'rastë ndaj 19 veprimtarëve të shquar shqiptar u sollën këto dënime: Azem Idriz Marana me vdekje-pushkatim, Kapiten Hysni Rudi me vdekje-pushkatim, Mehmet Bushi me vdekje-pushkatim, Qemal Skënderi me vdekje-pushkatim (më vonë ky dënim u zëvendësua me 20 vjet heqje lirie), Hasan Bilalli me 20 vjet heqje lirie, Dr.Qeram Zllatku me 20 vjet heqje lirie, Medat Tërshana me 18 vjet heqje lirie, Osman Cami me 15 vjet heqje lirie, Xhemal Fazli Kasami me 15 vjet heqje lirie,

mulla Hajdar Kurtish Jashari me 12 vjet heqje lirie, hafiz Mexhit Zyberi me 10 vjet heqje lirie, Jonuz Balla me 8 vjet heqje lirie, Xhavit Abdullah Selimi me 6 vjet heqje lirie, Galip Raufi me 6 vjet heqje lirie, Mahmut Dumani me 4 vjet heqje lirie, Nazmi Emin Azemi me 4 vjet heqje lirie, Spiro Harrilla Theodosi me 3 vjet heqje lirie, Gani bej Mehmet Abdullahu me 2 vjet heqje lirie dhe Sherif Ahmet Aliti me 2 vjet heqje lirie.

Dy muaj pasi përfundoi procesi gjyqësor kundër 19 anëtarëve të KQ të NDSH-së, po në qytetin e Shkupit, filloi procesi gjyqësor kundër grupit të dytë të NDSH-së i përbërë prej 7 intelektualëve e atdhetarëve shqiptarë: Suad Sulejman Mehmedi, Hetem Tahir Aliu, Nexhmedin Besim Sezairi, Jetish Sali Vishi, Ymer Qemal Sadiku, Abdylfari Beqir Ademi dhe Xhevair Vesel Shaqiri. Në fakt, të gjithë ata ishin udhëheqësit e komiteteve të NDSH-së për rajonin e Dervenit e të Tetovës.

Për dallim nga procesi i parë, i cili u zhvillua nga Gjyqi i Qarkut të këtij qytetit, procesi gjyqësor kundër grupit të dytë të NDSH-së, u zhvillua nga ana e Gjyqi Ushtarak-Divizioni i Shkupit, i cili më 24 mars 1947, solli vendim me të cilën shtatë të akuzuarit u dënuan me burg të rëndë në kohëzgjatje nga 3 deri më 18 vjet heqje lirie.

Regjimi komunist jugosllav, përkatësisht ai maqedonas, krahas mësuesve dhe veprimtarëve të Lë-

vizjes Nacional Demokratike Shqiptare, si armiq të tyre i konsideronte edhe ulematë shqiptarë, veçmas mbështetësit e politikës së Atullah Efendiut, përkatësisht pasardhësit e tij siç ishin: Fetah Efendiu, Mehmet Efendiu, Xhemal Efendiu, Ferat Efendiu e shumë të tjerë, të cilët deri në vdekje qëndruan besnik ndaj idealeve të tyre fetare e kombëtare. Në një dokument të hartuar në janar vitit 1947 nga ana e shërbimit sekret UDB-ë, përshkruheshin metodat e veprimtarisë së grupit të Atullah Hoxhës, të cilat ishin me sa vijon:

1. Gjatë kohës së okupacionit: qëndrim armiqësor ndaj LNÇ-së nga ana e drejtuesve kryesor, ndërsa përkrasitë e tyre në mënyrë aktive kanë luftuar kundër LNÇ-së në bashkëpunim me pushtuesin /Mulla Hamidi, Ferat Efendia/.

2. Pas çlirimit: Janë futur në frontin e pushtetit popullor, me qëllim të maskimit të veprimtarisë armiqësore e krijimit të besimit, e në anën tjetër, me qëllim të dobësimit nga brenda;

3. Ndarjen e masave nga fronti dhe krijimin e jo disponimit ndaj lëvizjes;

4. Shfrytëzimin e fesë në veprimtarinë antipopullore, duke i paraqitur rregulloret për kurorëzime, shkollave fetare, ndërprerjen e gjyqeve të shariatit etj., si sulm të drejtpërdrejtë të pushtetit ndaj fesë.

5. Krijimin e revoltës te masat

për dispozitat e mësipërme me qëllim që masat të kërkojnë ndërprerjen e tyre;

6. Nxitjen e urrejtjes fetare e nacionale midis popujve në Maqedoni me qëllim të cenimit të vëllazërim bashkimit;

7. Zgjerimin e lajmeve sensacionale për pasigurinë e shoqërisë, për luftën e re, për fitoren e anglo-amerikanëve dhe rrënimin e regjimit komunistë".

Si rrjedhojë e një konstatimi të tillë, në pranverë të vitit 1947 organet e UDB-së, burgosën grupin e teologëve që konsideroheshin si pasardhës të politikës së Atullah Hoxhës, në krye me Fetah ef. Raufin, Mehmet ef. Sadikun, Xhemal ef. Xhemalin, Ferat ef. Ibrahimin etj., Menduh Qazim Ahmetin dhe Riza Hamid Xheladinin, ndërsa më vonë të njëjtit u dënuan me burg të rëndë nga 6 deri më 12 vjet heqje lirie.

Në fillim të muajit shkurt të vitit 1948, organet policore maqedonase bastisën fshatin Zhelinë, me ç'rastë vranë ushtarakun e mirënjohur shqiptar, Arif Dragomancin, i njohur në popull si Arif Kapiteni si dhe gjashtë bashkëveprimtar të tij. Përveç kësaj u arrestuan edhe këta veprimtarë: Demir Esad Sulçe nga fshati Bellovishtë, Ibrahim Emin Musliu nga fshati Zhelinë, Nebi Vehap Ibrahimini nga fshati Zhelinë, mulla Garip Ramiz Beadini nga Tetova, hafiz Abdulla Hamid Abdulla nga fshati Zhelinë, Islam Shaban Zejnollau nga fshati Zhelinë, Ilmi Izair Islami nga fshati Zhelinë, Zyber Kadri Baftjari nga fshati Zhelinë, Demir Hashim Demiri nga fshati Zhelinë, Jusuf Mehmet Bajrami nga Tetova, Ismail Jusuf Selimi nga fshati Kopanicë - Shkup, Adem Jusuf Selimi nga fshati Kopanicë - Shkup, Selim Jusuf Selimi nga fshati Kopanicë - Shkup, Elez Abaz Rexhepi nga fshati Zhelinë, Demiral Havzi Emini nga fshati Debërcë- Tetovë dhe Tahir Qahil Tahiri nga fshati Zhelinë. Procesi gjyqësor kundër tyre u zhvillua në shtator të vitit 1948, me ç'rastë 13 të parët morrën dënime të rënda nga 3 deri më 20 vjet heqje lirie, ndërsa Elez Rexhepi, Demiral Emini dhe Murat Elezi u dënuan me punë të detyrueshme, kurse Tahir Tahiri u lirua si i pafajshëm. (fund)

DËNIMI I 19 VEPRIMTARËVE TË SHQUAR SHQIPTARË

Nga data 26 janar e deri më 7 shkurt të vitit 1947, në Shkup u mbajt procesi gjyqësor kundër kreut më të lartë të KQ të NDSH-së, me ç'rast ndaj 19 veprimtarëve të shquar shqiptarë u sollën këto dënime:

Azem Idriz Marana me vdekje-pushkatim, Kapiten Hysni Rudi me vdekje-pushkatim, Mehmet Bushi me vdekje-pushkatim, Qemal Skënderi me vdekje-pushkatim (më vonë ky dënim u zëvendësua me 20 vjet heqje lirie), Hasan Bilalli me 20 vjet heqje lirie, Dr.Qeram Zllatku me 20 vjet heqje lirie, Medat Tërshana me 18 vjet heqje lirie,



Osman Cami me 15 vjet heqje lirie, Xhemal Fazli Kasami me 15 vjet heqje lirie, mulla Hajdar Kurtish Jashari me 12 vjet heqje lirie, hafiz Mexhit Zyberi me 10 vjet heqje lirie, Jonuz Balla me 8 vjet heqje lirie, Xhavit Abdullah Selimi me 6 vjet heqje lirie, Galip Raufi me 6 vjet heqje lirie, Mahmut Dumani me 4 vjet heqje lirie, Nazmi Emin Azemi me 4 vjet heqje lirie, Spiro Harrilla Theodosi me 3 vjet heqje lirie, Gani bej Mehmet Abdullahu me 2 vjet heqje lirie dhe Sherif Ahmet Aliti me 2 vjet heqje lirie.

Vardari nuk ka se çfarë të humb pasi që moti ka humbur betejën me Shkëndijën në garën për titull, derisa kjo nuk vlen për FC Shkupi, që pikët nga kjo përballje i nevojiten më shumë se kurrë

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 13 prill - Java e 27-të në Ligën e parë futbolistike të Maqedonisë, e cila në program është të dielën, sjell derbin e madh ndërmjet Vardarit dhe FC Shkupi. Ndoshta tabela e klasifikimit nuk e dëshmon një gjë të tillë duke marr parasysh se Vardari ka 19-të pikë epërsi, por tradita mes këtyre dy skuadrave dhe rivaliteti që kanë kur takohen njëra me tjetrën, bën që të zgjojë interesim të madh në opinion. Ashtu do të jetë edhe tani, pa marr parasysh se në tribuna pritet të jetë qetë duke marr parasysh se tifozëve të FC Shkupi, "Shvercerat Shkup" sipas gjitha gjasave nuk do tu lejohet udhëtimi në arenën "Filipi i dytë", mirëpo në fushë pritet të zhvillohet një ndeshje e mirë. Vardari nuk ka se çfarë të humb pasi që moti ka humbur betejën me Shkëndijën në garën për titull, derisa kjo nuk vlen për FC Shkupi, që pikët nga kjo përballje i nevojiten më shumë se kurrë. Atmosfera në kampin bardhekaltër është e mirë, pa marr parasysh se ekipi radhiti dy humbje me radhë nën drejtimin e trajnerit Zekirja Ramadani. Tani kur kanë nevojë për pikë, futbolistët paralajmërojnë se mund t'ia arrijnë qëllimit dhe të arrijnë një rezultat të mirë. "Na pret një periudhë e vështirë, pasi ndeshjet do të luhen çdo të diele dhe të mërkure, sigurisht se ekipi po përgatitet maksimalisht, presim rezultate të mira pasi që kemi nevojë për pikë dhe shpresojmë që do ta fillojmë këtë cikël mirë. Për ndeshjen e të dielës do të them se është një ndeshje derbi, sigurisht

LIGA E PARË, JAVA E 27

SHKUPI NDAJ VARDARIT DËSHIRON REZULTAT POZITIV



se presim të ketë një 'luftë' maksimale dhe pa respekt ashtu siç i ka hije një ndeshje të këtyllë, pasi që kemi nevojë për pikët që të kthejmë atmosferë edhe më të mirë në ekip dhe presim në fund rezultat të mirë", deklaroi Edis Maliqi. FC Shkupi për këtë ndeshje në përjashtim të Vujçiq do të paraqitet me formacionin e saj më të mirë, ndërsa për 11-in e parë do të vendos trajneri Ramadani disa orë para ndeshjes.

Ndryshe, edhe pse mungon zyrtarizimi, skuadra e Shkëndijës pothuajse e ka të sigurt titullin e dytë në historinë e saj. Sfidat e radhës e kuqezinjve do të jetë Pelisteri, ndeshje kjo e cila do të zhvillohet në Manastir. Një kundërshtar me të cilin djemtë e trajnerit Qatip Osmani do të përballen edhe në

finalen e Kupës së Maqedonisë më 23 maj. Si gjithmonë nga tabori i kuqezinjve pohojnë se do të luajnë për fitore derisa nuk e mbyllin edhe matematikisht garën për titull. "Shkojmë drejt Manastirit për fitore ashtu si në çdo ndeshje tjetër. Kemi epërsi bindëse në pozitën e parë, por ne duam të vazhdojmë punën tonë profesionale deri në fund, për më shumë derisa edhe matematikisht nuk mbyllet çështja e titullit. Gjithsesi se epërsia na mundëson të jemi pak më të relaksuar, përballë një rivali që do ketë presionin e rezultatit duke parë pozitën e tyre të palakmueshme në luftën për mbijetesë. Ne do dalim në fushë për të dhënë më të mirën, të jemi në nivelin tonë të pritit dhe nëse luajmë ashtu si dimë, nuk dyshoj

DYSHET:

SKOPJE - RABOTNIČKI
RENOVA - POBEDA
PELISTERI - SHKËNDIJA
SILEKSI - A. PANDEV
VARDARI - SHKUPI

se do të kthehemi në Tetovë me tre pikë të reja", deklaroi për gazetën KOHA mbrojtësi i Shkëndijës, Mevlan Murati. Në përballjet tjera, Renova do të përballlet me Pobodën në stadiumin e qytetit në Tetovë, në një ndeshje ku imperativ është vetëm fitorja. Një gjë të tillë do ta kërkojnë edhe mysafirët nga Prilepi, pasi sikurse Renova edhe ata rrezikojnë mbetjen në elitën e futbollit vendor. Rabotnički do të ndeshet me "Skopjen", derisa Akademia Pandevi do të jetë mysafir i Sileksit në Kratovë.



Berisha mes Liverpulit dhe Njukasëllit

Mesfushori i përfaqësueses së Kosovës, Valon Berisha ka spikatur këtë sezon më shumë se kurrë në Liga Evropë dhe në kampionatin austriak të futbollit, duke zgjuar interesimin e shumë ekipeve të njohura. Mes pretendentëve për lojtarin janë dhe Liverpool dhe Njukasëll në kampionatin anglez. Skuadra e trajnerit Jurgen Klop ka nisur prej ditësh negociatën me agjentin e Valon Berishës, me vetë pëlqimin e futbollistit, por së fundmi është shtuar mes ekipeve që e duan edhe Njukasëll. Trajneri Rafael Benitez shikon te futbollisti kosovar një garanci për mesfushën në sezonin e ardhshëm, që do të shënojë ringjritjen e "Magpies" në elitë. Drejtuesit e Njukasëll kërkuar Berishën edhe në merkaton e janarit, por lojtari vendosi që të mos largohet nga Salzburgu. Valon Berisha ka lindur në Suedi, por ka një trajektore të çuditshme në karrierën e tij, pasi nuk zgjodhi vendlindjen për të luajtur me kombëtaren, por preferoi Norvegjinë. Pas njohjes zyrtare të Kosovës nga FIFA, ai luan prej 2 vjetësh me përfaqësuesen e Kosovës.

Uells, kundërshtari i ri i Shqipërisë



Kombëtarja e Shqipërisë do të luajë miqësore me Uellsin në datë 20 nëntor në "Elbasan Arena". Të dyja federatat përkatëse kanë gjetur akordin dhe kanë zyrtarizuar zhvillimin e këtij takimi në këtë datë. Kujtojmë që në periudhën shtator-dhjetor të këtij viti, skuadra përfaqësuese e

Shqipërisë do të zhvillojë takimet zyrtare eliminatorë për grupin e saj në kompeticionin e Ligës së Kombeve (UEFA Nations League), por duke qenë se grupi është me tre skuadra ajo do të zhvillojë në datat përkatëse edhe dy ndeshje miqësore, një prej të cilave është kjo me Uellsin.

Tare shumë pranë rinovimit me Lacion



Igli Tare dhe klubi i Lacios do të vazhdojnë bashkë edhe në të ardhmen. Drejtori sportiv i bardhekaltërve ka vendosur të rinovojë dhe do ta bëjë këtë gjë gjatë javëve në vazhdim. Gjasat janë që rinovimi të jetë deri në vitin 2020. Gjithçka duket një formalitet në këtë drejtim, por për evituar çdo surprizë do të nënsh-

ruhet kontrata përkatëse. Igli Tare e ka thënë më parë se nuk e shqetësonte aspak rinovimi dhe se çdo gjë ishte në rregull. Tare ka një marrëdhënie shumë të mirë me presidentin Klaudio Lotito dhe kërkon të vazhdojë projektin e tij te Lacio për të tjera suksese. Së fundi ai fitoi çmimin "Drejtori më i mirë sportiv i vitit 2017", pasi ka

bërë një punë të shkëlqyer në merkato, duke i sjellë klubit roman përfitimi të konsiderueshme financiare nga shitja e lojtarëve. Kohë më parë për Taren ka pasur interesim nga Interi, duke parë punën e mirë që shqiptari ka bërë me Lacion, teksa ka sjellë në ekip lojtarë "anonimë" që më pas janë bërë më të kërkuarit në merkato.

SIPAS MENAXHERIT PINI ZAHAVI

NEJMAR S'MUND TË LUAJË ME RONALDON APO MESSIN

Ai tani është tërhequr në debat, lidhur me një lëvizje të madhe të parave për një superstar global, ku Real Madridi vazhdon të lidhet me blerjen e një tjetër "galactico". Zahavi, megjithatë, sugjeroi se Neymar duhet të mbajë "pavarësinë" e tij, në mënyrë që të lulëzojë. Një lëvizje te Real Madridi do të krijonte të njëjtat probleme për Neymarin, që përfundimisht e detyruan largimin e tij nga "Camp Nou"

Neymar duhet të mbetet jashtë hijes së Lionel Messit dhe Cristiano Ronaldos, pretendon Pini Zahavi, duke hedhur dyshime për një kalim të propozuar të sulmuesit brazilian te Real Madridi. I ashtuquajtur "super agjent" ndihmoi për të ndërmjetësuar një transferim rekord prej 222 milionë euro të Neymar nga Barcelona te PSZH, verën e vitit të kaluar. Zahavi raportohet se ka mbajtur lidhje të ngushta me Neymar, teksa "UOL Esporte" pretendon se agjenti nga Izraeli ishte pjesë e një delegacioni të PSZH-së,



që udhëtoi në Amerikën e Jugut në mars, për të kontrolluar shërimin e 26-vjeçarit nga operacioni i këmbës. Ai tani është tërhequr në debat, lidhur me një lëvizje të madhe të parave për një superstar global, ku Real Madridi vazhdon të lidhet me blerjen e një tjetër "galactico". Zahavi, megjithatë, sugjeroi se Neymar duhet të mbajë "pavarësinë" e tij, në mënyrë që të lulë-

zojë. Një lëvizje te Real Madridi do të krijonte të njëjtat probleme për Neymarin, që përfundimisht e detyruan largimin e tij nga "Camp Nou".

"Neymar bëri atë që duhej. Ka vetëm tre superstarë të futbollit sot; Messi, Ronaldo dhe Neymar. Ata nuk mund të luajnë në një klub. E Barça, Neymar ishte gjithmonë nr.2. Ai ishte i dyti për të goditur gjuajtjet e lira, i dyti për goditjet e dënimit, i dyti për gjithçka. Neymar erdhi në Spanjë si djalë i ri, ndërsa tani është 26 vjeç dhe ka tetë, ose nëntë vite për të luajtur në nivelin më të lartë", tha ai për "Przeгляд Sportowy". Zahavi shtoi diçka për ndikimin që një superstar global si Neymar ka pasur në Francë. "PSZH ka plane të mëdha. Para se të kalonte Neymar te PSZH, vetëm francezët e shihnin Ligue 1. Neymar e ndryshoi këtë gjë".



Kovaç do të jetë trajneri i ri i Bajernit

Mesa duket Bajerni i ka dhënë fund kërkimit për trajnerin e ri. Sipas informacioneve të "Bild", Niko Kovaç do të jetë trashëgimtari i Jupp Heynkes në stolin e Bajernit. Drejtuesit e klubit gjerman kanë lajmëruar disa javë më parë se trajneri i ri do të vendoset gjatë prillit. 46-vjeçari ka një kontratë deri në 2019 me Eintracht Frankfurt që do të thotë se Bajerni duhet të paguajë një shumë parash për të marrë shërbimet e tij. Kovaç ka luajtur te Bajerni nga 2001 deri 2003 dhe ka fituar titullin dhe Kupën e Gjermanisë. Pas u bë e qartë se Heynkes nuk do të ishte në stolin bavarez sezonin e ardhshëm, Kovaç ishte kandidati kryesor pasi i ka të gjitha kriteret. Ka luajtur te Bajerni, di gjermanisht dhe ka eksperiencë në Bundesliga si trajner.

Publicitet

Në bazë të nenit 17 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve të tjera të lira për nxënësit e shkollave fillore të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 07-9992/2 të datës 05.06.2014 dhe Programit vjetor për punë të shkollës në vitin shkollor 2017/2018, SHFK "Aleksandar Zdravkovski", Jegunovce, Komuna e Jegunovcës, në vijim publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për grumbullimin e ofertave për realizim të ekskursioneve për nxënësit dhe aktiviteteve tjera të lira (furnizim i ndarë)

1. Ekskursion njëditor për 90 nxënësit e vitit të tretë, të gjashtë dhe të nëntë
Ruta e udhëtimit: nisja nga Jegunovca në ora 8:30 – Tetovë – Gostivar – Kërçovë – Strugë – Vevçan – Strugë – Ohër, kthimi Ohër – Kërçovë – Gostivar – Tetovë – Jegunovcë, arrijte në Jegunovcë në ora 20.00.
 2. Mësim katër ditor në natyrë për 22 nxënësit të klasës së pestë në Strugë.
Ruta e udhëtimit: nisja nga Jegunovca në ora 8:00 – Tetovë – Gostivar – Mavrovë – Sv. Jovan Bigorski – Strugë (3 bujtje) – Ohër – Kërçovë – Gostivar – Tetovë – arrijte në Jegunovcë në ora 20.00.
- Në ofertë të përbahen:
- çmimi individual dhe i përgjithshëm i shërbimit (akomodim, transport dhe ushqim);
 - kushtet për akomodim, meny të ushqimit dhe transport;
 - sigurim të posaçëm të fëmijëve;
 - mënyra e pagesës;
 - guidë, numër të mësimdhënësve dhe mjek;
 - kushte të vulltshme për nxënësit të cilët rrjedhin nga familjet e prekura sociale.
- Realizimi i ekskursionit nën pikën 1 është gjatë muajit maj, ndërsa nën pikën 2 është në periudhë prej 10 maj deri në 13 maj 2018.

KRITERI PËR NDARJE TË MARRËVESHJES

- Ofertuesi të regjistrohet në pajtim me dispozitat pozitive në Republikën e Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë turistike (licenca A);
- Ka të realizuar në mënyrë të suksesshme së paku tri ekskursione për nxënësit dhe aktivitete tjera të lira në tri vitet e fundit;
- Përbushë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve.

Për të dëshmuar kushtet minimale, ofertuesi duhet të parashtrojë:

- Dokument për veprimtari të regjistruar si dëshmi se është i regjistruar si subjekt fizik ose juridik për kryerje të veprimtarisë turistike;
- Dëshmi për realizim të suksesshëm të së paku tri ekskursioneve të nxënësve dhe aktiviteteve tjera të lira në tri vitet e fundit;
- Dëshmi për kushte të plotësuara për transport të grupeve të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat udhëtojnë grupet e fëmijëve.

(Dokumentet parashtrohen në origjinal ose kopje të nënshkruara dhe vërtetuara nga ofertuesi me shenjë "E besueshme nga origjinali").

Oferta e ofertuesit i cili nuk përbushë kushtet do të refuzohet nga ana e Komisionit si e papranueshme.

Kriteri për ndarje të marrëveshjes për furnizim të shërbimit – realizim të ekskursioneve për nxënësit do të jetë çmimi më i ulët i ofruar.

Në kushtet e ofertës nuk duhet të ketë zgjidhje alternative, kushtet duhet të jenë saktë të përcaktuara pa mundësi për t'u ndryshuar.

Shpallja publike zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Ofertat të parashtrohen në arkivin e SHFK "Aleksandar Zdravkovski", Jegunovce ose përmes postës në adresën SHFK "Aleksandar Zdravkovski", Jegunovce rr. 101 nr. pr me shenjë "Për Komisionin për grumbullim të ofertave".

Hapja e ofertave do të realizohet nga ana e Komisionit për realizim të ekskursionit.

Komisioni për realizim të ekskursionit
Kryetar
Jordanka Bllazheska

Interi mund të jetë destinacioni i ri i Bejll

Interi do të lëvizë për të marrë Geret Bejll gjatë verës, në momentin që Real Madridi do të vendosë përfundimisht për shitjen e "yllit" nga Uellsit. Teksa Bejll ka thënë disa herë se dëshiron të qëndrojë në "Bernabeu", drejtuesit e Real Madridit e mendojnë ndryshe dhe kërkojnë të rinovojë sulmin e ekipit të Zinedin Zidane. Bejll nuk është më me të preferuarit e presidentit Florentino Perez dhe sipas "The Independent" drejtuesit "Los Blancos" kanë nisur t'ia ofrojnë disa klubeve evrop-



tarin që kushtoi 100 milionë euro në vitin 2013. Flitet se edhe klube të tjera angleze janë tërhequr nga gara, por për lojtarin është interesuar Interi. Mesa duket zikaltërit kanë ende kujtimin e një ndeshje që ai luajti kundër tyre në vitin 2011, ku padyshim ishte më e mira e karrierës dhe u njoh nga e gjithë Evropa me tre gola në "San Siro". Gjithsesi, Interi më parë duhet të sigurojë pjesëmarrjen në Çampionat Ligë sezonin e ardhshëm, si kusht i vetëm për të investuar te 29-vjeçari nga Uellsit.

Rashford kërkon largimin nga Junajted

Sipas "The Mirror", sulmuesi i Manchester Junajted, Markus Rashford, mund të largohet nga "dajtë" nëse Hoze Murinjo do të jetë trajner edhe sezonin e ardhshëm. Sulmuesi i Anglisë dëshiron të luajë diku gjetkë për të marrë minutat që i kanë munguar në këtë sezon. Rashford është rritur në klubin e Junajted dhe ka lënë një përshtypje të shkëlqyer me ekipin e parë ku në 115 ndeshje zyrtare duke shënuar 48 gola. Gjithsesi, 20-vjeçari ka luajtur vetëm 14 ndeshje në këtë sezon si ti-

tullar, ndërsa në 15 raste të tjera është aktivizuar në pjesën e dytë. Romelu Lukaku ka qenë dhe do të jetë titullari i Junajted, ndërsa Sançez dhe Martial kompletojnë treshen e sulmit në më të shumtën e rasteve, kësajoh Rashford mendon se ky është muaji i tij i fundit me "dajtë". Sulmuesi, që merr 65 mijë euro në javë, i ka dyert e hapura në të pjesën më të madhe të ekipeve në Premier Ligë, por vendimin përfundimtar do ta marrë pas Kupës së Botës 2018 në Rusi.

LIGA E KAMPIONËVE - PËRBALLJE SURPRIZASH

BAJERN - REAL, FINALE E PARAKOHSHME

"Më duhet të them, është ndeshje fantastike. Një ndeshje gjigante, në formë shumë pozitive. Unë kam kujtime shumë të mira nga sezoni i tripletës. Ne kemi luajtur ndaj Juventusit dhe Barcelonës në shtëpi së pari dhe shpresoj se ky është një ogur i mirë", deklaroi Hejnkës pas tërheqjes së shortit

ndeshje fantastike. Një ndeshje gjigante, në formë shumë pozitive. Unë kam kujtime shumë të mira nga sezoni i tripletës. Ne kemi luajtur ndaj Juventusit dhe Barcelonës në shtëpi së pari dhe shpresoj se ky është një ogur i mirë", deklaroi Hejnkës pas tërheqjes së shortit. Finalja e madhe do të luhet në

kryeqytetin ukrainas, Kiev, më 26 maj. Ndërkohë, dje u hodh edhe shorti i gjysmëfinaleve të Ligës së Evropës. Atletico Madrid do të përballlet me Arsenalin, në rrugën drejt finales, që do të luhet në Lion, më 16 maj. Ndeshja e parë do të luhet në "Emirates", ndërsa kthimi do të jetë në "Wanda Metropolita-

ne". Derisa, gjysmëfinalja tjetër vë përballë Marsejën dhe Salzburgun. Ndeshja e parë në "Velodrome", ndërsa kthimi në Austri. Kujtojmë se për këtë raund, ndeshjet e para do të luhen të enjten, më 26 prill, ndërsa ato të kthimit do të jenë një javë më vonë, të enjten, më 3 maj.



Në Nion të Zvicrës u hodh edhe shorti për gjysmëfinale të Ligës së kampionëve. Në gjysmëfinale të kualifikuan Roma, Bajern Muni, Real Madrid dhe Liverpool, praktikisht nga një përfaqësues për secilin nga kampionatet më të forta evropiane. Shorti i gjysmëfinaleve propozoi dy takime mjaft interesante, teksa Bajern Muni do të presë Realin e Madridit në gjysmëfinale, takim që mund të cilësohet edhe si

një finale e parakohshme. Dy surprizat e gjysmëfinaleve, Liverpool dhe Roma do të përballen me njëra-tjetrën, për të përcaktuar finalistin tjetër. Takimet gjysmëfinale do të luhen më 24 dhe 25 prill, ndërsa më 1 dhe 2 maj do të luhen ndeshjet e kthimit. Ndryshe, trajneri i Bajern Muni, Jupp Hejnkës, është shprehur tejet i entuziazmuar për duelin ndaj Real Madridit. "Më duhet të them, është

Publicitet



Fury shpall datën e rikthimit

Tyson Fury shprehet se do të rikthehet më 9 qershor me qëllim për të rimarrë titullin e kampionit të botës. Anthony Joshua është tre-katër ndeshje larg horizontit por Fury nuk ka asnjë dyshim se ai do ta mposhtë bashkë me rivalin amerikan me lehtësi. "Do të jem unë ai që do të zgjedhë kundërshtarin por do t'i vijë edhe dita Joshuas. Tyson është një boksier i madh dhe ai duhet të jetë gati fizikisht – për të rimarrë titujt që nuk humbi asnjëherë në ring," shprehet promovuesi i ti Warren. "Ndeshja ndaj Joshua do të ndodhë pas tre-katër sfidave, kur të jemi gati do ta shtypim butonin." "Kur të vijë momenti do të ketë vuajtje për të tjerët," shprehet Fury. "Ata që mendojnë se janë më të mirët në botë, nuk janë. Kam humbur peshë, kam filluar të ndeshem 12 raunde në stërvitje. Do të jetë e lehtë të bëhem përsëri kampion. E patë ndeshjen me Parker, ai ka probleme ndaj atyre që që lëvizin shumë. "Do ta mposht pas disa raundeve lekcionit. Wilder është një nga më të mirët pasi është i rrezikshëm deri në sekondën e fundit. Por nuk është boksieri më i mirë në botë. "Jam rikthyer."

Relaksohu

Shiko televizion kudo që të jesh me Vip Combo Neo

Me pakot e reja Vip Combo Neo fitoni:

- televizion kudo që të jeni me Vip NOW,
- zgjedhje më e madhe e kanaleve televizive HD me përmbajtjen më të pasur filmike,
- Internet për shtëpinë Tuaj me shpejtësi deri në 100Mbps,
- linjë fikse falas me biseda të pakufizuar drejt të gjitha rrjeteve fikse kombëtare dhe
- deri në 3 linja celulare me zbritje shtesë të parapagimit.

Me shërbimin Vip NOW që e fitoni falas, lehtë dhe thjeshtë mund të ndiqni çdo gjë që ju intereson në TV, direkt në celularin, tabletin ose kompjuterin Tuaj.

Oferta vlen për kontratë të re dhe me ripërtirjen e kontratës ekzistuese të lidhur në 24 muaj për të gjithë 4 tarifatat të Vip Combo Neo 4 dhe Vip Combo Lite Neo. Kur përdorni shërbimin Vip NOW, harxhoni internet. Oferta është në dispozicion në Shkup, Manastir, Tetovë, Gostivar, Kumanovë, Veles, Koçan, Shtip, Radovish dhe Prilep, në vende ku ka mundësi teknike për të përdorur shërbimin.

Për më shumë informata, vizitoni faqen tonë të internetit www.vip.mk ose telefononi në 077 1234.



Më tepër për ju **vip**

DASHI 21. mars - 20. prill

Ju po jetoni një fazë energjie të madhe dhe do të keni një qëndrim më pozitiv ndaj problemeve të jetës së përditshme. Gjërat do të përmirohen edhe me partnerin/en. Me Saturnin në kundërshtim me shenjën tuaj, beqarët nuk do të kenë takime të frytshme. Faza e rëndësishme që po kaloni po ndikon në aspektin profesional. Së shpejti do të arrihi qëllimet e dëshiruara.

DEMI 21. prill - 21. maj

Edhe pse Hëna në kundërshtim me ju, yjet janë aq të mira sa që sot pak do të jenë gjërat negative që mund t'ju ndodhin me të dashurin/en. Beqarët nuk do mundin në asnjë mënyrë të shmangin emocionet e mëdha edhe pse ata do të përpiqen, disa do të jenë vendimtare për jetën e tyre. Është një kohë e mirë për të zgjidhur disa çështje ligjore.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Shumë Binjakë nuk do të jenë të lirë nga shqetësimet, por do të jetojnë gjithashtu aventura dhe emocionet e reja që jeta do të dëshirojë t'ju japë sot. Zemrat e vetmuara mund të lidhen përsëri me një person të rëndësishëm me të cilin i kishit ndërprerë marrëdhëniet në të kaluarën. Vendosen në vend çështje të ndryshme të punës.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Nëse do të rregullosh një marrëdhënie, të fillosh një histori që ke ndërprerë, do të keni rrugën të pastër nga yjet. Gjeneri kohë për t'i kushtuar vetes dhe ndjenjave! Për beqarët do të jetë një ditë plot me projekte dhe premtime të reja! Ju jeni të aftë dhe keni rikuperuar rënie fizike në punë, por angazhimet janë të ngutshme dhe ju duhet të lëvizni.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Melankolia ju bën të ndiheni vetëm. Ndjenia të zhgënjyer nga dashuria apo është vetëm ndryshimi i temperaturës? Bëni gjithçka me qetësi dhe shijoni mundësitë e mira në dashuri. Beqarët sot do të duhet të merren me njerëz që nuk i kuptojnë. Qëndrueshmëri në investime. Mbani sytë hapur lidhur me çdo projekt tuajin.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Do të jetë një ditë shumë e favorshme, dashuria shkon mirë dhe madje edhe miqësitë. Zemra dhe mendja sot pajtohen plotësisht. Nëse jeni vetëm, së shpejti do të keni mundësi të keni takime të mrekullueshme dhe shumë prej jush do të bien në dashuri seriozish. Ju jeni duke kryer aktivitetet tuaja me saktësi të madhe. Mundohuni të kultivoni miqësi të dobishme edhe për jetën profesionale.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Pasiguria dhe dyshimet kthehen në zemrën tuaj sot, edhe yjet nuk do jenë shumë të favorshme për ju. Qjelli ju këshillon të jeni të kujdesshëm sidomos në marrëdhëniet me partnerin/en. Zemrat e vetmuara do të marrin një lajm të mirë që do t'i bëjë ata të lumtur. Projektet e reja duhet të menaxhohen më mirë për të shkruar përpara.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kjo është një periudhë shumë e rëndësishme dhe ju do të duhet të përballeni me shumë vendime që ju kanë lënë disi të hutuar. Ndoshta keni kuptuar se marrëdhënia me partnerin/en po ndryshon. Beqarët do të jenë të lumtur për të filluar një njohje të re me një person interesant. Mundësi të reja për të treguar aftësitë tuaja. Mos u ndalni në humbjet e para.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Ditë e nënshtruar lehtë, do të duhet të marrësh vendime që mund të dallohen me mendimet e atyre që janë pranë jush. Krahasoni veten me partnerin/en. Beqarët do të jenë të angazhuar në planifikimin se çfarë do të bëjnë në lidhje me një fundjavë për ta kaluar me miqtë. Kohë interesante për punën, do të keni perspektiva të reja për tu referuar dhe sigurisht nuk do të hiqni dorë.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Sot yjet me siguri do të jenë më mirë se disa ditë më parë, por jeta juaj private nuk është ende e qartë. Mos e mbani gjithçka brenda, besojni sekretet tuaja personit të zemrës. Beqarët do të duhet të heqin dorë nëse dikush u ka kthyer kurrizin, ndryshoni rrugën tuaj! Është një ditë e kontrasteve të mëdha, por mund të ketë implikime pozitive dhe të ndryshojë pozicionin tuaj.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Yjet premtajnë një fundjavë të qetë dhe tashmë po përgatiteni të shkëputeni me mendje dhe zemër nga rutina e përditshmërisë! Disa beqarë janë gati për t'u përballur me një ndryshim në jetën e tyre. Fati ju rezervon gjëra të mëdha! Një ditë e kënaqshme në punë, së shpejti do të keni lavdërim nga eprorët. Transferime në horizont.


PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Ditë e shkëlqyeshme nga pikëpamja sentimentale, qjelli këtë të premte është edhe më i bukur dhe do të jetoni ndjenja intime me partnerin/en. Projekte të rëndësishme vijnë së shpejti. Beqarët të bëhen miq me disa nga shenjat e Gaforres, por ka një Akrep që do i shkelni syrin! Sot ju mund të merrni një konfirmim në punë, varet nga ju çfarë do të zgjidhni.

Koha Koha	PASHAI I FAMSHEM NGA FOTO	SHTËPI PËR JETIMËT (shum.)	MASË DRITHRASH (vjet.) (shq.)	ZETA-BIT	BASHKIMI I PJESËVE	SOLISTE JONA, ZUKA								
MENDRA (bot.)	○													
▶	○													
REVISTË E NUJHUR PËR MESHKUJ AKTORJA, RINA	○				N. SH. I PA- FUQISHËM, I PAAFTË									
KUSARE DETI	○													
LLOJ BASHKË- DYZIMI KIMIK (shq.)	○											I ACARUAR (mjek.)		
SH. O. MOSHATAR	○			KËNGËTARJA PERUANE, SUMAK VRULL I BRENDSHËM										
▶	○										NORVEGJIA	EPILEPSIA	LLOJ BARKE PËR LUNDRIM NËPËR KANALE	SHOK (frenj.) LUMË NË MONGOLI
SHKRONJË E ALFABETIT GREK	○				SEND I VETËM LLOJ VEPRE LETRARE (shq.)									
▶	○										MURGU BUDIST SHËNDETË- SORE, HIGJENIKE			
INVESTIGI- MET PORTUGALIA	○		HISTIDINA (kim.) KANCERO- GJEN								AKTORI AMERIKAN, STIVEN LUMË NË MAL TË ZI			
COPË LETRE QË I NGJITET NJË MALLI (shum.)	○												RADIUM MINDERE	
LUTEC	○		VENDLINDJA E ODISEUT	QYTETI I TJ DETERXHENT PËR DUAR	○	○	○	○	○	○	○	○	○	RROFSH (spanj.)
I DËRGUARI SPECIAL	○												MENDIM QË NA LIND VJERSHË LIRIKE A KËNGË SOLE- MNE (shum.)	
SHENJA MUZIKORE	○										PJESË E MOLEKULËS IRIQI (krah.)			VOLT SIPËR, LART
ZEZAKE	○										NJERIU I PARË EDI MARFI			
		MAMI, OBSTETËR POND											B. V. RREZE	
DEGË E GJEOMETRISË ELEMENTARE														



FJALËKRYQ MOZAIK



Në vend të përshkrimit janë të dhëna fjalët me ndihmën e të cilave duhet ta rekonstruoni fjalëkryqin.

- 2 shkronja: LLE, DE, EA, KK, TO, YZ
- 3 shkronja: APA, DEF, EKU, ELA, EMA, INI, KALL, TIT.
- 4 shkronja: ANRI, ATAK, FILA, KECA, TANI, TOGA.
- 5 shkronja: LLADIK, ANATO, ARAGO, DETET, EMINE, ENORM, KAKIN, MALLRA, MADAM, NEFES, SADAM, ZAIFE, ZANAT.
- 6 shkronja: AVICIN, KAZINO, KIMONO, NOKSAN, OLIMPI, YRNEKU.
- 7 shkronja: PIKETIM, SKALION.
- 9 shkronja: DIREKTIVA, SPORADIKE

ZGJITHJET: AJAZMA, PLEBJOI, ITA, NSH, PRATE, AMIDI, SHO, IMA, VËRSNIK K, TETA, UNIKAT, HETMET, LAMA, P, HIS, SEGAL, ETIKETAT, RA, LU, JANINA, EMISSARI, IDE, NOTA, ATOM, V, ARAPE, ADEMI, AKUSHERE, BY, PLANIMETRIA, FJALËKR, MOZAIK, DETET, NEFES, KIMONO, OLIMPI, ARAGO, SKALION, LLE, ARAKS, ANRI, KK, MADAM, EA, ATAK, ZANAT, DE, PIKETIM, LLADIK, AVICIN, YRNEKU, ANATO, ZAIFE.

Gjendet në Suedi qepa e vjetër 1500 vjeç



Në fshatin Sandy Borg të ishullit suedez Ölanda gjatë një gërmimi është gjetur një qepë e vjetër 1500 vjeç. Arkeologja Helena Victor, në deklaratën e saj për gazetën The Local, njoftoi se kanë gjetur një qepë të djegur e vjetër 1500 vjet. Ajo tha se në ato vite në Skandinavi nuk ka pasur kultivim të qepës dhe vuri në dukje se qepa mund të ketë qenë e importuar nga Perandoria Romake. Victor theksoi se qepën e kanë gjetur pranë një oxhaku gjatë gërmimeve në një kala antike. Ajo tha se kjo do të hedhë dritë mbi marrëdhëniet e afërta tregtare të atyre që kanë jetuar në rajon me Perandorinë Romake.

Humbet këmbët, gishtat dhe hundën nga një gërvishtje



Një burrë ka humbur të dyja këmbët, hundën, si edhe të gjithë gishtat në dorën e djathtë, pasi qeni i tij e ka gërvishtur. Jaco Nel, 50 vjeç, u prek nga një infeksion pasi po luante me qenin në shtëpinë e tij në Manchester, kur qeni e gërvishti në dorë. Jaco, një psikiatër, ishte në punë kur atij iu shfaqën simptoma të ngjashme me gripin. Pasi la punën për të shkuar të qetësohej në shtëpi, Jaco filloi të kishte dridhje në trup duke u shoqëruar me dhimbje torturuese. Mjekët vunë re pulla të kuqe në lëkurën e 50-vjeçarit, një simptomë e helmimit në gjak ose Sepsis. Sipas The Sun, katër muaj pasi u pranua në spital, mjekët u detyruan t'i prisnin atij të dyja këmbët poshtë gjurit. Ai humbi të gjithë gishtat në të djathtën dhe një në



dorën e majtë, dhe kishte nevojë për kirurgji rindërtuese në fytyrë duke humbur kështu edhe hundën. Mjekët më vonë zbuluan se qeni mbante baktere të dëmshme në pëstymën e tij duke shkaktuar helmim në gjak.

Apple Music arrin 40 milionë përdorues me pagesë

Apple Music ka arritur 40 milionë përdorues me pagesë dhe ka emërtuar një zëvendës-president të ri, Oliver Schusser si rezultat i kësaj. Schusser qe 14 vite ka punuar në Apple dhe ka qenë i përfshirë në App Store, filmat në iTunes, në sektorin televiziv, iBooks, e tani në krye të Apple Music, transmeton koha.net.

Arritja e Apple Music me 40 milionë përdorues me pagesë është shumë mbresëlënëse, por parashikimet fillestare që thoshin se mund ta kalonte Spotify në SHBA deri në verë të 2018, ishin shumë të eksagjeruara. Spotify shpreson që të arrij 200 milion përdorues aktiv deri në fund të vitit.

60 DEPUTETË BRAZILIANË TANI EDHE ME MBIEMRIN E ISH-PRESIDENTIT TË ARRESTUAR, LULA

"Gjashtëdhjetë Lula në Parlamentin e Brazilit. Ky është titulli i një deklaratë të Partisë së Punëtorëve (PT, e majtë) të Brazilit, e cila njoftoi të mërkurën se të gjithë këta deputetë do t'i shtinin mbiemrin "Lula" mbiemrit të tyre, në formë proteste kundër lënies në burg të ish-presidentit brazilian, Luiz Inacio Lula da Silva. Kjo iniciativë e pazakontë ngjalli një kundërsulm nga ana e deputetëve të së djathtës. "Kërkoj që emri i parlamentarit, Paulo Pimenta të zëvendësohet nga Paulo Lula Pimenta u shpreh në këtë mënyrë lideri i PT-së në Dhomën e Ulët", në një dokument zyrtar të konsultuar nga media.



"Kërkesa të tjera të këtij formati u dërguan në asambljetë lokale, përfshirë këshillat bashkiakë", sqaroi një zëdhënës i kësaj partie të themeluar nga Lula në vitet '80. "Kjo është një mënyrë për të shfaqur solidaritetin tonë", shtoi zëdhënësi, duke theksuar se senatorja Gleisi Hoffmann, kryetarja e partisë kishte kërkuar gjithashtu që "Lula" t'i bashkëngjitej gjithashtu mbiemrit të saj.

kur solidaritetin tonë", shtoi zëdhënësi, duke theksuar se senatorja Gleisi Hoffmann, kryetarja e partisë kishte kërkuar gjithashtu që "Lula" t'i bashkëngjitej gjithashtu mbiemrit të saj.

193 - Lucius Septimus Severus kurorëzohet perandor romak
 966 - Kristianizimi Polonisë
 1799 - Napoleoni fton në ndërtimin e Jerusalemit për evrejtë
 1809 - Napoleoni mund Austrinë në Betejën e Abensbergut, Bavaria
 1865 - Atentati ndaj Presidentit Abraham Linkoln nga ana e Xhon Uajlks Buth në Teatrin e Fordit
 1915 - Turqit sulmojnë Ermeninë
 1941 - Mbreti Pjetër largohet nga Jugosllavia
 1987 - Turqia kërkon t'i bashkangjitet Tregut europian
 1999 - NATO gabimisht sulmon konvojën e refugjatëve shqiptarë
 2002 - Kryetari i Venecuelës Hugo Çavez kthehet në post dy ditë pas largimit dhe arrestimit nga ana e ushtrisë së shtetit



Sipërfaqja prej rreth 370 metrash katrorë - "Air Force One" është më shumë sesa thjesht i madh. Edhe pse konsiderohet si avion privat i "PO-TUS"-it, ai është një mekanizëm tejet i avancuar ajror dhe me një siguri të lartë, si të ishte një kështjellë fluturuese. Po, është mjaftueshëm i madh sa për të qenë një shtëpi, që ofron hapësira për të gjithë zyrtarët qeveritarë, gazetarët, bagazhet e cilitdo prej tyre, veçanërisht të Zonjës së Parë. Ndërsa shumica e avionëve të pasagjerëve "Boeing 747" janë dykatësh, "Air Force One" ka tri të tilla. Presidenti futet në katin e dytë, ndërsa gazetarët qëndrojnë në katin e parë. "Air Force One" është i aftë të fluturojë me shpejtësi mbi 650 milje në orë (mbi 1.000 km/h). Ai besohet të ketë fluturuar edhe më shpejt sesa 700 milje në orë (mbi 1.100 km/h) në të kaluarën.

AI DHE AJO

Ajo: Shpirt, më duket vetja shumë e shëndoshë, e shëmtuar dhe e plakur. Të lutem më bëj një kompliment.

Ai: Zemër ke shikim shumë të mirë...



Sa më i artikuluar të jesh, aq më të rrezikshme bëhen fjalët.

(MAY SARTON)



KALENDARI HISTORIK 14 PRILL



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS